

20191612570

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR AUTOMJETE

Neni 1

Në Ligjin për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 140/2008, 53/11, 123/12, 70/13, 164/13, 138/14, 154/15, 192/15 dhe 39/16), në nenin 3 në pikën 52 fjala "ministri" zëvendësohet me fjalën "Ministria".

Në pikën 66 lidhëza "dhe" zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën 67 pika zëvendësohet me pikëpresje dhe shtohen tri pika të reja 68, 69 dhe 70 si vijojnë:

„68. **"Leje qarkullimi"** është dokumenti publik që e lëshon organi kompetent, me të cilin dëshmohet pronësia e automjetit, e drejta e shënimit të automjetit të caktuar me targa regjistrimi, cilësitë teknike dhe cilësitë e tjera dhe karakteristikat e automjetit, të drejtën për të marrë pjesë në komunikacion, si dhe periudha e vlefshmërisë së lejes së qarkullimit;

69. **"Kategori ekologjike e automjeteve"** është kategoria e automjeteve sipas nivelit të emetimit të gazrave të nxjerra nga automjetet me motor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse, përkatësisht rregullat e ECE ose EC; dhe

70. **"Etiketë ekologjike"** është shenjë e cila vendoset në automjet dhe e cila e shënon kategorinë ekologjike të automjetit."

Neni 2

Pas nenit 5-a shtohen dy nene të reja 5-b dhe 5-v, si vijojnë:

"Neni 5-b

Kategorizimi ekologjik i automjeteve

(1) Automjetet të cilat marrin pjesë në komunikacionin rrugor doemos duhet të shënohen me etiketë ekologjike për shkak të shënimit të kategorisë ekologjike të automjetit në pajtim me rezultatet matëse të emisionit të gazrave në ajër.

(2) Me përjashtim, automjetet e projektuara dhe përpunuara veçanërisht për nevojat e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, policisë, ndihmës së shpejtë, shërbimeve kundër zjarrit nuk kanë kategorizim ekologjik të automjetit në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Automjetet e personave plotësisht të shurdhër me vërtetim për anëtarësim nga Lidhja Nacionale për persona të shurdhër, persona të sëmurë nga distrofia, multipleks skleroza, paraliza cerebrale, paraplegjia, hemiplegjia, kuadriplemia, paraliza e fëmijëve (poliomielitis), pesona të verbër me dëmtim të shikimit mbi 90%, persona në dializë dhe persona me amputacion të dorës ose këmbës me dëmtim trupor të pranuar prej 80% të përcaktuar me akt të komisionit kompetent në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk kanë kategorizim ekologjik të automjetit në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

(4) Kategorizimin ekologjik të automjeteve e kryen shërbimi teknik nga neni 57 paragrafi (1) të këtij ligji.

(5) Kategorizimi ekologjik i automjetit kryhet në tri kategori ekologjike, edhe atë:

- kategoria e parë ekologjike, e cila i përfshin automjetet me nivel të emisioneve të gazrave të nxjerra EURO 5 e më lartë, si dhe automjetet me emisione të gazrave të nxjerra EURO 4 EURO 3 në të cilat është i montuar aparat për motor të gazit të lëngët të naftës ose motor me gaz tokësor të komprimuar, automjetet hibride dhe automjetet elektrike, si dhe automjetet që kanë të futur pajisje që e zvogëlon emisionin e gazrave në ajër dhe i arrijnë standardet e EURO 4, 5 dhe më lartë,

- kategoria e dytë ekologjike, e cila i përfshin automjetet me nivel të emisionit të gazrave të nxjerra EURO 4 dhe EURO 3,

- kategoria e tretë ekologjike, e cila i përfshin automjetet me nivel të emisionit të gazrave të nxjerra EURO 2 dhe më poshtë, si dhe automjetet për të cilat prodhuesi nuk ka definuar emision të gazrave të nxjerra.

(6) Automjetet për të cilat është kryer kategorizim ekologjik shënohen me etiketë ekologjike në ngjyrë të gjelbër, të verdhë dhe të kuqe, në varësi të kategorisë ekologjike, si vijon:

- automjetet e kategorisë së parë ekologjike shënohen me etiketë ekologjike me ngjyrë të gjelbër,

- automjetet e kategorisë së dytë ekologjike shënohen me etiketë ekologjike me ngjyrë të verdhë,

- automjetet e kategorisë së tretë ekologjike shënohen me etiketë ekologjike me ngjyrë të kuqe.

(7) Procedura për shënimin e kategorisë ekologjike të automjetit, në pajtim me rezultatet matëse të emisionit të gazrave në ajër fillon me parashtrimin e kërkesës me dokumentacion përcjellës për përcaktimin e kategorisë ekologjike të automjetit në pajtim me rezultatet matëse të emisionit të gazrave në ajër nga pronari i automjetit të shërbimi i autorizuar teknik.

(8) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (7) i këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm përcjellës i përcakton ministri i Ekonomisë.

(9) Shërbimi teknik e kontrollon dokumentacionin e dorëzuar, e përcakton kategorinë ekologjike të automjetit, në pajtim me rezultatet matëse të emisionit të gazrave në ajër për çfarë jep vërtetim dhe etiketë ekologjike në ngjyrë adekuate.

(10) Shpenzimet në procedurë për përcaktimin e kategorisë ekologjike të automjetit, janë në ngarkim të pronarit të automjetit.

(11) Shpenzimet nga paragrafi (10) i këtij neni i përcakton ministri i Ekonomisë, në pajtim me shpenzimet për zbatimin e procedurës, personelin e angazhuar dhe kohëzgjatjen e të njëjtës.

(12) Gjobë në shumë prej 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shërbimit teknik nga paragrafi (4) të këtij neni, nëse vepron në kundërshtim të dispozitave të paragrafëve (5) dhe (6) të këtij neni.

(13) Gjobë në shumë prej 250 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shërbimin teknik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (12) të këtij neni."

Neni 5-v

Programe për subvencione për automjete

(1) Me qëllim të rritjes së sigurisë në komunikacion rrugor, zvogëlimit të shpenzimeve për mirëmbajtjen e automjetit, zvogëlimin e ndotjes së ajrit të ambientit, si dhe rritjen e transportit të automjeteve të reja përkatësisht të përdorura, Ministria e Ekonomisë për vitin rrjedhës fiskal në pajtim me automjetet e planifikuara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përgatit:

- Program për subvencionim të një pjese të shpenzimeve për montimin e aparateve për motor me GLN ose lloj tjetër të karburantit alternativ,

- Program për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve për blerjen e automjetit të ri me çregjistrimin e automjetit të vjetër në pajtim me nenin 41 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Programet nga paragrafi (1) të këtij neni posaçërisht përmbajnë:

- instrumente dhe masa, si dhe aktivitete për zbatimin e masave,

- orar kohor, dinamikë dhe afate për zbatim,

- mënyrën, llojin, lartësinë dhe kushtet për ndarje të subvencioneve dhe

- kornizë financiare indikative për zbatimin e tyre.

(3) Programet nga paragrafi (1) i këtij neni i miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të ministrit të Ekonomisë, në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(4) Ministria e Ekonomisë dorëzon raport për programet e realizuara nga paragrafi (1) i këtij neni për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vitin rrjedhës për vitin paraprak."

Neni 3

Në nenin 11 paragrafi (1) alineja 14 ndryshohet si vijon:

"- kushtet hapësinore, materiale-teknike dhe të sigurisë, si dhe kushtet në lidhje me kuadrin për personat juridikë që montojnë aparate për motor me gaz të lëngët të naftës dhe/ose të gazit të komprimuar tokësor dhe lartësia e shpenzimeve në procedurë për lëshimin e vërtetimit për aparat të montuar në pajtim me nenin 54-a të këtij ligji."

Në alinenë 18 lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje.

Në alinenë 19 pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën "dhe" dhe shtohet aline e re 20, si vijon:

"- caktimin e kategorisë ekologjike të automjeteve, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e vendosjes së etiketës ekologjike, si dhe lartësinë e shpenzimeve për përcaktimin e kategorisë ekologjike të automjetit dhe për përgatitjen e etiketës ekologjike."

Neni 4

Në nenin 12 paragrafi (6) pas fjalës "mban" shtohet fjala "elektronike".

Pas paragrafit (6) shtohen katër paragrafë të rinj (7), (8), (9) dhe (10), si vijojnë:

"(7) Pranimin e kërkesës e evidenton organi për miratim dhe e kontrollon dokumentacionin e paraqitur për prodhimin. Organi për miratim mund në mënyrë plotësuese me arsyetim të kërkojë nga prodhuesi të dorëzojë edhe informata tjera të nevojshme për miratimin e lejes së tipit të prodhimit.

(8) Nëse prodhimi i përmbush kërkesat në pajtim me dispozitat e këtij ligji, organi për miratim në bazë të dokumentacionit të paraqitur të kontrolluar për prodhimin, në afat prej 30 ditësh miraton leje për tip të prodhimit.

(9) Nëse prodhimi nuk i përmbush kërkesat në pajtim me dispozitat e këtij ligji, përkatësisht nëse konstaton se prodhimi paraqet rrezik të madh për sigurinë në komunikacionin rrugor, organi për miratim miraton aktvendim për refuzim të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni.

(10) Kundër aktvendimit nga paragrafi (9) i këtij neni, prodhuesi mund të parashtrojë ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë në Marrëdhënie Pune në Shkallë të Dytë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit."

Neni 5

Paragrafi 17 ndryshohet si vijon:

"(1) Miratimi individual i automjeteve është procedurë në të cilën organi për miratim në bazë të konstatimit të shërbimit të autorizuar teknik vërteton se automjeti i kontrolluar individual, unik ose jo, i përmbush kërkesat e përcaktuara dhe në pajtim me ato prodhuesit, përfaqësuesit të prodhuesit ose pronarit të automjetit i lëshon leje për automjet individual me numër identifikues të shasisë dhe numër të motorit të automjetit, si dhe të dhënë për formë dhe dedikim të karrocërisë së automjetit.

(2) Procedura nga paragrafi (1) i këtij neni, fillon me parashtrimin e kërkesës për marrje të lejes për automjet individual, me dokumentacion shoqërues, nga prodhuesi, përfaqësuesi i prodhuesit ose pronari i automjetit në organin për miratim përmes shërbimit të autorizuar teknik.

(3) Procedura nga paragrafi (1) i këtij neni bëhet për:

- automjet tipi i të cilit nuk është miratuar në pajtim me rregullat e harmonizuara për BE miratim të tipit, as nuk ekziston leje e tipit në Republikën e Maqedonisë së Veriut,

- automjet unik, automjet për dedikim special i cili nuk është përfshirë në alinenë 1 të këtij neni, si dhe për automjet në fazën e fundit nga miratim në më shumë faza,

- automjet tipi i të cilit është miratuar në pajtim me rregullat e harmonizuara për miratimin BE të tipit, ose ekziston leje e tipit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por i njëjti nuk është regjistruar, e është riparuar, gjegjësisht është kryer ndryshim i automjetit që i përfshin të dhënat e evidentuara në procedurën e regjistrimit të automjetit, kërkon ndryshim të kategorisë së automjetit, ndikon në pjesët e lejuara përbërëse, sistemet dhe njësitë e pavarura teknike, përkatësisht ndikon ose mund të ndikojë në sigurinë e automjetit.

(4) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni dhe dokumentacionin e nevojshëm shoqërues i përcakton ministri i Ekonomisë.

(5) Shërbimi teknik i cili e kontrollon dokumentacionin e paraqitur për automjetin përgatit konstatim për automjetin dhe në shtojcë të kërkesës e dërgon në formë elektronike në organin për miratim.

(6) Shpenzimet në procedurën për lëshimin e lejes për automjet unik janë në ngarkim të kërkuarit nga paragrafi (2) i këtij neni.

(7) Organi për miratim në bazë të konstatimit për automjetin në shërbimin e autorizuar teknik vërteton se automjeti individual i kontrolluar i përmbush kërkesat në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe në afat prej 15 ditësh miraton leje për automjet individual, që e dërgon në formë elektronike në shërbimin teknik.

(8) Nëse organi për miratim, konstaton se nuk janë përmbushur kërkesat në pajtim me dispozitat e këtij ligji, miraton aktvendim në formë me shkrim për refuzim të kërkesës për lëshim të lejes për automjet individual.

(9) Kundër aktvendimit nga paragrafi (8) i këtij neni, mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(10) Shërbimi i autorizuar teknik në bazë të lejes së lëshuar për automjet individual nga organi për miratim kërkuarit nga paragrafi (2) i këtij i lëshon vërtetim për përputhshmëri të formularit numerik dhe të mbrojtur.

(11) Formularët nga paragrafi (10) i këtij neni i lëshon organi për miratim.

(12) Shërbimi i autorizuar teknik mban evidencë elektronike për vërtetimet e lëshuara për përputhshmëri nga paragrafi (11) nga ky nen dhe të njëjtat i ruan 15 vjet.

(13) Gjohë në shumë prej 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar të organit për miratim, nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafët (7) dhe (8) të këtij neni.

(14) Gjohë në shumë prej 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shërbimit të autorizuar teknik, nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafët (5), (10) dhe (12) të këtij neni.

(15) Gjohë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë me do t'i shqiptohet personit përgjegjës të shërbimi i autorizuar teknik që vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi (14) i këtij neni."

Neni 6

Në nenin 20 paragrafi (7) ndryshohet si vijon:

"Organi për miratim mban evidencë elektronike për lejet e lëshuara nga paragrafët (1) dhe (6) të këtij neni dhe të njëjtat i ruan 15 vjet."

Në paragrafin (10) fjalët: "30% nga gjoha e matur për prodhuesin-person juridik" zëvendësohen me fjalët: "500 euro në kundërvlerë me denarë".

Në paragrafin (12) fjalët: "30% nga gjoha e matur për shërbimin teknik" zëvendësohen me fjalët: "500 euro në kundërvlerë me denarë".

Neni 7

Në nenin 22 paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Organi për miratim mban evidencë elektronike për pëlqime për regjistrim të cilat janë lëshuar nga ana e shërbimit teknik dhe personit juridik për kontroll teknik të autorizuar për procedurë për identifikim dhe/ose identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjetit dhe të njëjtat i ruan 15 vjet."

Në paragrafin (7) fjalët: "30% nga gjoba e matur për personin juridik për kontroll teknik" zëvendësohen me fjalët: "500 euro në kundërvlerë me denarë".

Neni 8

Në nenin 24 paragrafi (1) në pikën 3) pas fjalëve: "familje më të ngushtë" të shtohen fjalët: "të cilat kanë letërnjoftim të vlefshëm diplomatik, konsullor ose zyrtar".

Pikat 4) dhe 5) shlyhen.

Pika 6) bëhet pikë 4), ndërsa pikët 7) dhe 8) bëhen pikë 5) dhe 6).

Paragrafi (4) shlyhet.

Paragrafi (5) bëhet paragraf (4).

Neni 9

Në nenin 26 paragrafin (1) alineja 2 shlyhet.

Në alinenë 3 pas fjalëve: "vojitje provuese" shtohen fjalët: "ose urdhëresë për vojitje provuese dhe shfrytëzim të automjetit me targë metalike bartëse."

Në paragrafin (2) pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: "përkatësisht urdhëresë për vojitje provuese dhe shfrytëzim të automjetit me targa metalike bartëse."

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

"(4) Me kërkesë të pronarit, për rimorkio të lehtë lëshohet targë e veçantë dhe leje qarkullimi."

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (5) dhe (6).

Në paragrafin (6) i cili bëhet paragraf (7) pas fjalëve: "dokumente për regjistrim të automjeteve" shtohen fjalët: "sigurim i detyrueshëm (policë)".

Paragrafët (7) dhe (8) bëhen paragrafë (8) dhe (9).

Në paragrafin (9) i cili bëhet paragraf (10) fjalët: "paragrafët (1) dhe (4)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (1) alinetë 1, 3 dhe 4, paragrafi (5), paragrafi (7) dhe paragrafi (8)".

Në paragrafin (10) i cili bëhet paragraf (11) pas fjalëve: "paragrafi (1)" shtohen fjalët: "alinetë 1, 3 dhe 4".

Paragrafi (11) bëhet paragraf (12).

Në paragrafin (12) i cili bëhet paragraf (13) fjalët: "(1) dhe (4)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (1) alinetë 1, 3 dhe 4, paragrafi (5), paragrafi (7) dhe paragrafi (8)".

Paragrafi (13) bëhet paragraf (14).

Në paragrafin (14) i cili bëhet paragraf (15) fjalët: "(4) dhe (6)" zëvendësohen me fjalët: "(3) dhe (5)".

Paragrafët (15) dhe (16) bëhen paragrafë (16) dhe (17).

Në paragrafin (17) i cili bëhet paragraf (18) fjalët: "30% nga gjoba e matur për personin juridik" zëvendësohen me fjalët: "500 euro në kundërvlerë me denarë".

Neni 10

Në nenin 27 në paragrafin (1) alineja 5 ndryshohet si vijon:

Alineja 10 ndryshohet si vijon:

"- formën dhe përmbajtjen e urdhëresës për vozitje provuese, mënyrën e lëshimit dhe shfrytëzimit të urdhëresës për vozitje provuese dhe shfrytëzimit të automjetit me targë metalike bartëse provuese, si dhe formën dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për lëshimin e tyre."

Neni 11

Në nenin 28 paragrafi (1) fjalët: "dhe lëshimi i etiketës për regjistrim të kryer" shlyhen.

Paragrafi (5) shlyhet.

Paragrafi (6) bëhet paragraf (5).

Neni 12

Në nenin 31 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Me kërkesën për regjistrim nga paragrafi (1) të këtij neni pronari i automjetit është i detyruar t'i paraqesë provat me shkrim, si vijojnë:

- origjina e automjetit,
- pronësia e automjetit,
- obligimet tatimore dhe doganore të rregulluara për automjetin,
- vërtetim për përputhshmëri, ose pëlqim për regjistrim, nëse bëhet fjalë për automjet për të cilin duhet të ketë vërtetim të tillë ose pëlqim në pajtim me dispozitat e këtij ligji,
- rregullshmëria teknike e automjetit, përveç për automjet për të cilin kontrolli teknik nuk është i detyrueshëm, në pajtim me nenin 50 të këtij ligji,
- certifikatë e vlefshme nga licenca për transport autotaksi të udhëtarëve,
- shënim nga vlerat e matura të emetimit të gazrave të nxjerra të automjetit,
- shënim për rregullshmërinë teknike të sistemit për frenim të automjetit,
- shënim për rregullshmërinë teknike të sistemit për drejtim të automjetit,
- vërtetim për përcaktimin e karakteristikave minimale teknike dhe eksploatime për makinë mobile të lëshuar në procedurë të identifikimit dhe vlerësimit të kushteve të gjendjes teknike të makinës mobile.
- sigurim i kryer, taksa të paguara, tatime të rregulluara në emër të kompensimeve për shfrytëzimin e rrugëve publike dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe detyrime tjera të përcaktuara me ligj,
- ADR certifikatë për analizë të kryer të automjetit për transport të materieve të rrezikshme në komunikacionin rrugor,
- çregjistrim i kryer i automjetit nga organi kompetent në të cilin është kryer regjistrimi paraprak dhe
- statusi i automjetit me vlerë historike (olldtajmer).

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Provat nga paragrafi (2) alinetë 5, 7, 8 dhe 9 të këtij neni verifikohen nga dy punëtorë profesionalë-kontrollorë nga personi juridik për kryerjen e kontrollit teknik të automjeteve."

Neni 13

Pas nenit 31 shtohet nen i ri 31-a si vijon:

"Neni 31-a

Anulimi i regjistrimit të automjeteve

Regjistrimi i automjetit anulohet nëse Ministria e Punëve të Brendshme gjatë kontrollit mbikëqyrës përcakton se provat nga neni 31 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji, të paraqitura në procedurën për regjistrimin e automjetit janë të pavërteta."

Neni 14

Në nëntitullin e nenit 32 presja dhe fjalët: "etiketa për regjistrimin e kryer" shlyhen.

Në paragrafin (1) pas fjalëve: "leje qarkullimi", fshihet presja dhe fjalët: "etiketa për regjistrim të kryer" fshihen.

Në paragrafin (2), fjalët: "etiketa për regjistrim të kryer" fshihet.

Në paragrafin (3) pas fjalëve: "leje qarkullimi", presja dhe fjalët: "etiketa për regjistrim të kryer" fshihen.

Në paragrafin (4) pas fjalëve: "leje qarkullimi", presja dhe fjalët: "etiketa për regjistrim të kryer" fshihen.

Neni 15

Në nëntitullin e "Pjesës së Tretë" fjalët: "etiketë për regjistrim të kryer" zëvendësohen me fjalët: "etiketë ekologjike".

Neni 16

Në nenin 33 paragrafi (4) ndryshohet dhe vijon:

"Për qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, me kërkesë të tyre personale, në formularin për leje qarkullimi shtypen edhe të dhënat për emrin personal, vendbanimin respektivisht vendqëndrimin ose selinë e personit juridik regjistruhen edhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin që e përdor qytetari."

Në paragrafin (8) fjalët: "Makinë mobile, motokultivator" zëvendësohet me fjalët: "Motokultivator".

Në paragrafin (9), fjalët: "dhe të shënohen me etiketë për regjistrim të kryer" fshihet.

Paragrafi (10) ndryshohet si vijon:

"Pronari i traktorit dhe/ose rimorkios së traktorit, makinës mobile dhe rimorkios së lehtë është i obliguar në çdo gjashtë vite nga dita e regjistrimit të parë t'i paraqesë dëshmitë në procedurën e regjistrimit në pajtim me nenin 31 paragrafi (2) alinetë 5 dhe 11 të Ligjit për automjete."

Paragrafi (11) ndryshohet si vijon:

"Pronari i automjetit nga paragrafi (10) të këtij neni, gjatë vazhdimit të vlefshmërisë së lejes së qarkullimit është i detyruar të paraqesë dëshmi për sigurim të kryer dhe vërtetim për rregullshmëri teknike të automjetit, përkatësisht vërtetim për inspektim teknik të kryer të automjetit."

Pas paragrafit (18) shtohen tre paragrafë të rinj (19), (20) dhe (21), si vijojnë:

"(19) Gjobë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (11) të këtij neni.

(20) Gjobë në shumën prej 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personit juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (19) të këtij neni.

"(21) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje pronarit të automjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (11) të këtij neni."

Neni 17

Neni 33-a ndryshohet si vijon:

"Neni 33-a Etiketa ekologjike

(1) Etiketat ekologjike i ndajnë shërbimet teknike të autorizuara nga Ministria e Ekonomisë për të kryer kategorizim ekologjik të automjeteve.

(2) Etiketa ekologjike detyrimisht duhet të ketë cilësi dhe mbrojtje të përcaktuara me dispozitën nga neni 11 paragrafi (1), alineja 20 të këtij ligji.

(3) Nuk lejohet të ndryshohet etiketa ekologjike. Automjeti nuk mund të jetë në komunikacion rrugor me etiketë tjetër ekologjike nga e përcaktuara, ose me etiketë të ndryshuar nga ajo e ndarë nga shërbimi teknik.

(4) Etiketa ekologjike duhet të vendoset në mënyrë të përcaktuar me dispozitat nga neni 11 paragrafi (1), alineja 20 të këtij ligji.

(5) Etiketa ekologjike duhet të jetë e dukshme mirë dhe e lexueshme dhe të mos jetë e dëmtuar.

(6) Gjobë në shumë prej 100 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje pronarit të automjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij neni."

Neni 18

Në nenin 34 në paragrafin (1), pas fjalëve: "katërçikleta të lehta", shtohet fjala "katërçikleta,".

Neni 19

Neni 38 ndryshohet si vijon:

"(1) Vërtetimi për vozitje provuese, urdhëresa për vozitje provuese, targa provuese në formë letre dhe targa metalike provuese bartëse pronarit të automjetit i mundësojnë shfrytëzim të përkohshëm të automjetit të peregjistruar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Vërtetimi për vozitje provuese dhe targat provuese në formë letre lëshohet me vlefshmëri deri në pesë ditë, kurse evidencën për targa provuese të lëshuara në formë letre dhe vërtetime për vozitje provuese e mban Ministria e Punëve të Brendshme dhe të njëjtat i ruajnë një vit.

(3) Urdhëresa për vozitje provuese dhe targat metalike bartëse provuese mund të lëshohen për vitin kalendarik për të cilin shfrytëzohen targat metalike bartëse provuese të personave juridikë që kryejnë prodhim dhe/ose lëshojnë automjete në treg, kurse evidencën për urdhëresat e lëshuara dhe targat bartëse provuese e udhëheq Ministria e Punëve të Brendshme dhe e ruan dy vjet.

(4) Vërtetimi i lëshuar për vozitje provuese dhe targa provuese nga paragrafi (2) të këtij neni, si dhe urdhëresa për targa metalike bartëse provuese dhe si dhe targa provuese nga paragrafi (3) të këtij neni, shfrytëzohen për shënim vetëm të automjetit me të cilin kryhet vozitje provuese.

(5) Ministria e Punëve të Brendshme për një numër regjistrimi nga targa metalike bartëse provuese, lëshon një dhe/ose më shumë urdhëresa për vozitje provuese dhe përdorimin e automjetit me targë metalike bartëse provuese gjatë vitit kalendarik për të cilin vlen targa metalike bartëse provuese e lëshuar personave juridikë që kryejnë prodhim dhe/ose lëshojnë në treg automjete, në bazë të kërkesës së tyre.

(6) Personat juridikë që kryejnë prodhim dhe/ose lëshojnë automjete në treg me kërkesën nga paragrafi (5) të këtij neni i bashkëngjisin provat si vijojnë:

a) personat juridikë që kryejnë prodhim:

- dëshmi për veprimtari të regjistruar,

- dëshmi për sigurim të detyrueshëm të lidhur nga auto përgjegjësia për vitin kalendarik për të cilin do ta përdorë targën metalike bartëse provuese dhe urdhëresën për vozitje provuese dhe shfrytëzimin e automjetit/eve,

- vërtetim për përputhshmëri për tip të miratuar të automjetit dhe/ose vërtetim për karakteristika tekniko- eksploative për tip të automjetit/ve të lëshuar nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe

- taksa të paguara;

b) personat juridikë të cilët lëshojnë automjete në treg:

- dëshmi për veprimtari të regjistruar,
- dëshmi për sigurim të detyrueshëm të lidhur të automjeteve që i lëshojnë në treg për vitin kalendarik për të cilin do ta shfrytëzojnë targën metalike bartëse provuese dhe urdhëresë për vozitje provuese dhe shfrytëzimin e automjetit/ve.

- vërtetim për përputhshmëri për tip të miratuar të automjetit të ri ose vërtetim për përputhshmëri, respektivisht pëlqim për regjistrim të automjetit të importuar të përdorur ose vërtetim për karakteristikat tekniko- eksploatuese të përcaktuara për tip të automjetit të lëshuar nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij në Republikën e Maqedonisë së Veriut,

- dëshmi për obligime doganore të rregulluara për automjetin/et dhe,
- taksa të paguara.

(7) Urdhëresa për vozitje provuese dhe targa metalike bartëse provuese përdoren për të shënuar automjetet që janë në pronësi të personave juridikë që kryejnë prodhim dhe/ose lëshojnë automjete në treg ose janë nën mbikëqyrje doganore. Vërtetimet e lëshuara për vozitje provuese, urdhëresa për vozitje provuese dhe targat provuese nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni pronari i automjetit mund t'i shfrytëzojë ekskluzivisht për lëvizje deri te vendet e përcaktuara për kontroll teknik të automjeteve, te organi kompetent për regjistrim të automjeteve, zbatimin e procedurës doganore, procedurës së miratimit të automjeteve, modifikim ose riparim, ekspozitë, manifestim respektivisht shitje të automjeteve, vendeve për magazinim ose ruajtje, si dhe për automjete për të cilat kryhet vozitje provuese.

(8) Gjatë shfrytëzimit të targave metalike bartëse provuese personat juridikë që kryejnë prodhim dhe/ose lëshimin e automjeteve në treg detyrimisht është e nevojshme të kenë urdhëresë për vozitje provuese dhe shfrytëzimin e automjetit me targë metalike bartëse provuese.

(9) Për vërtetimet e lëshuara për vozitje provuese, urdhëresat për vozitje provuese dhe targë provuese nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, regjistër mban Ministria e Punëve të Brendshme.

(10) Evidencë për vërtetime të lëshuara për vozitje provuese dhe targa provuese në formë letre, mbajnë personat juridikë të autorizuar për kryerjen e kontrolleve teknike të automjeteve dhe personat juridikë të cilët lëshojnë automjete në treg.

(11) Të dhënat të përmbajtura në regjistrin, respektivisht evidencën nga paragrafët (9) dhe (10) të këtij neni ruhen në kohëzgjatje prej tre viteve.

(12) Ministria e Punëve të Brendshme si person juridik për kryerjen e kontrolleve teknike të automjeteve ose personi juridik i cili lëshon automjete në treg janë të obliguar në hapësirën ku parashtrohet kërkesa për lëshimin e vërtetimit për vozitje provuese dhe tabelës provuese, në vend të dukshëm të theksojnë informata për mënyrën e shfrytëzimit dhe përdorimit të vërtetimit për vozitje provuese dhe targa provuese për informim.

(13) Në rastin nga paragrafi (2) të këtij neni, vërtetimin për vozitje provuese dhe targa provuese në formë letre e lëshon Ministria e Punëve të Brendshme drejtpërdrejt ose përmes personit juridik për kryerjen kontrollit teknik të automjetit ose përmes personit juridik me të cilën merret me lëshimin në treg të automjetit.

(14) Ministri i Punëve të Brendshme me aktvendim e përcakton shumën e shpenzimeve për lëshimin e urdhëresës për vozitje provuese dhe shfrytëzimin e automjeti me targa portative metalike provë, në pajtim me shpenzimet për përpunim dhe shtypjen e të njëjtës.

(15) Personin juridik që kryen kontroll teknik të automjeteve dhe personin juridik që lëshon automjete në treg për kryerjen e punëve nga paragrafi (2) të këtij neni, i autorizon Ministria e Punëve të Brendshme me kërkesë të tyre.

(16) Gjobjë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet shoferit i cili drejton automjet me motor në komunikacion rrugor në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, pa poseduar vërtetim për vozitje provuese, urdhëresë për vozitje provuese dhe targa provuese nga paragrafët (2) ose (3) të këtij neni.

(17) Personave juridikë të autorizuar që kryejnë kontroll teknik të automjeteve dhe personave juridikë që prodhojnë dhe/ose lëshojnë automjete në treg nëse nuk veprojnë në pajtim me dispozitat e paragrafëve (2), (3), (4), (7), (8), (10) dhe (11) të këtij neni, do t'u shqiptohet gjobë për kundërvajtje në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë me denarë.

(18) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personit juridik për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (17) të këtij neni."

Neni 20

Në nenin 40 paragrafi (1) fjalët: "automjeti i regjistruar" zëvendësohen me fjalën "automjeti".
Në pikën 5) lidhëza "dhe" zëvendësohet me shenjën e interpunksionit“;”.

Në pikën 6) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën "dhe" dhe shtohet pikë e re 7), si vijon:

"7) është kryer ndryshim i rajonit të regjistrimit."

Pas paragrafit (2) shtohen tre paragrafë të rinj (3), (4) dhe (5) si vijojnë:

"(3) Çregjistrim të automjetit, përveç pronarit i cili është evidentuar në lejen e qarkullimit mund të kryejë edhe pronari i ri i automjetit, nëse dorëzon dokument adekuat me të cilin dëshmohet pronësia.

(4) Pronari nga paragrafi (3) i këtij neni nuk ka obligim t'i kthejë targat e regjistrimit nëse me marrëveshjen e shitblerjes ose me deklaratë me shkrim të dhënë në Ministrinë e Punëve të Brendshme - rajonin e regjistrimit ku për automjetin mbahet evidencë, ia kalon pronarit të ri-blerës dhe me këtë rast nuk kryhet ndryshim i rajonit të regjistrimit.

(5) Për automjetet që janë të konfiskuar me aktgjykim gjyqësor të plotfuqishëm, ç'lajmërim të automjeteve nga evidenca e automjeteve kryen Ministria e Punëve të Brendshme me kërkesë të pronarit të ri, në bazë të dokumentit përkatës të dorëzuar me të cilin e dëshmon pronësinë të dorëzuar te organi ku automjeti mbahet në evidencë."

Paragrafi (3) bëhet paragraf (6).

Në paragrafin (4) i cili bëhet paragrafi (7), fjalët: "një vit" zëvendësohen me fjalët: "90 ditë".

Paragrafët (5) dhe (6) bëhen paragrafë (8) dhe (9).

Pas paragrafit (7) i cili bëhet paragraf (10) shtohen dy paragrafë të rinj (11) dhe (12) si vijojnë:

"(11) Nëse automjeti dërgohet në hedhurina për automjete, pronari i automjetit i cili është evidentuar në lejen e qarkullimit, para se ta çojë në shkatërrim, të njëjtin e ç'lajmëron në Ministrinë e Punëve të Brendshme- rajoni i regjistrimit ku automjeti mbahet në evidencë.

(12) Gjatë çregjistrimit të automjetit në pajtim me paragrafin (11) të këtij neni, Ministria e Punëve të Brendshme- rajoni i regjistrimit ku automjeti mbahet në evidencë lëshon vërtetim se automjeti është i çregjistruar dhe mund të dërgohet në hedhurina për automjete."

Në paragrafin (8) i cili bëhet paragraf (13) fjalët: "paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6" zëvendësohen me fjalët: "paragrafët (1) pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6 dhe paragrafi (3)".

Në paragrafin (9) bëhet paragraf (14) numri "400" zëvendësohet me numri "250".

Në paragrafin (10) i cili bëhet paragrafi (15) pas fjalëve: "paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6" shtohen fjalët: "dhe paragrafi (3)".

Në paragrafin (11) i cili bëhet paragrafi (16), fjalët: "30% nga gjoba e matur për personin juridik" zëvendësohen me fjalët: "500 euro në kundërvlerë me denarë", ndërsa fjalët "paragrafi (10) zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (15)".

Paragrafi (12) bëhet paragraf (17).

Në paragrafin (13) i cili bëhet paragraf (18), fjalët: "30% nga gjoba e matur për personin juridik" zëvendësohen me fjalët: "500 euro në kundërvlerë me denarë", ndërsa fjalët: "paragrafi (12)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (17)".

Neni 21

Neni 41 ndryshohet si vijon:

"Detyrimet e pronarit gjatë çregjistrimit të automjetit

(1) Pronari i automjetit që ka status të automjetit të përdorur, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, krahas detyrimeve nga neni 40 paragrafi (1) pika 1 të këtij ligji, gjatë çregjistrimit të automjetit është i detyruar të paraqesë vërtetim për marrjen e automjetit të përdorur për shkatërrim.

(2) Pronari i automjetit që nuk ka status të automjetit të përdorur, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, gjatë çregjistrimit të automjetit është i detyruar të plotësojë deklaratë për lokacionin ku gjendet automjeti. Ministria e Punëve të Brendshme, deklaratën e dërgon në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Automjeti i çregjistruar duhet të gjendet në lokacionin që është shënuar në deklaratën nga ky paragraf.

(3) Personat juridikë ose fizikë që kanë marrë leje për kryerjen e veprimtarisë përkatëse në pajtim me dispozitat për menaxhim me mbeturina nga ana e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor nuk guxojnë të kryejnë marrje të automjetit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nëse i njëjti nuk është çregjistruar në evidencën e automjeteve të regjistruara në Ministrinë e Punëve të Brendshme, respektivisht pronari nuk dorëzon leje qarkullimi në të cilën është evidentuar çregjistrimit i automjetit në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) alineja 2 të këtij ligji ose vërtetim se automjeti është çregjistruar të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme me kërkesë të pronarit të automjetit.

(4) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje pronarit të automjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (3) të këtij neni.

(6) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (1), (2) dhe (3) të këtij neni.

(7) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personi juridik për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (6) të këtij neni."

Neni 22

Në nenin 48 paragrafi (1) alineja 6 ndryshohet si vijon:

"- shuma e shpenzimeve në procedurën për kontroll të rregullshmërisë teknike të automjetit në pajtim me nenin 49 të këtij ligji,".

Neni 23

Në nenin 49 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

"(2) Autenticiteti dhe saktësia e të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, me nënshkrim dhe vulë, konfirmohen dhe verifikohen në kërkesën për regjistrim nga ana e punëtorëve profesionistë nga personi juridik për kontroll teknik."

Paragrafi (2) bëhet paragraf (3).

Në paragrafin (3) i cili bëhet paragraf (4) fjalët: "paragrafi (2)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (3)" e pas paragrafit (4) shtohen tre paragrafë të rinj (5), (6) dhe (7) si vijojnë:

"(5) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik të autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni.

(6) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës tek personit i autorizuar juridik për kontroll teknik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (5) të këtij neni.

(7) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje punëtorit profesionist që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni."

Neni 24

Në nenin 50 në paragrafin (1) fjalët: " dhe makina mobile" shlyhen.

Neni 25

Në nenin 51 paragrafi (1) në pikën 2) pas fjalëve: "të gjitha automjetet tjera" shtohen fjalët: "të cilat nuk janë theksuar në paragrafin (1) pikat 1) dhe 3) të këtij neni".

Pas paragrafit (6) shtohen dy paragrafë të rinj (7) dhe (8) si vijojnë:

"(7) Gjobë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik - pronar i automjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (3) të këtij neni.

(8) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personit juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (7) të këtij neni."

Në paragrafin (7) i cili bëhet paragraf (9) pas fjalëve: "pronari i automjetit motorik" shtohet fjalët: "- person fizik".

Neni 26

Në nenin 54 në paragrafin (2) pas alinesë 2 shtohet aline e re 3 si vijon:

"- aparat për motor me gaz të lëngët të naftës dhe gaz të komprimuar tokësor,".

Në paragrafin (3) pas fjalëve: "paragrafi (2)" shtohen fjalët: "alinetë 1, 2, 4 dhe 5".

Paragrafët (4), (5), (6), (7) dhe (8) fshihen.

Paragrafët (9) dhe (10) bëhen paragrafë (4) dhe (5).

Në paragrafin (11) i cili bëhet paragraf (6), fjalët: "30% nga gjoba e matur për personin juridik" zëvendësohen me fjalët: "300 euro në kundërvlerë me denarë", ndërsa fjalët: "paragrafi (10)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (5)".

Paragrafi (12) shlyhet.

Neni 27

Pas nenit 54 shtohet nen i ri 54-a, si vijon:

"Neni 54-a

Autorizimi për montimin e aparateve për motor për gaz të lëngët të naftës dhe gaz të komprimuar tokësor

(1) Montimin e aparateve për motor të gaz të lëngët të naftës dhe gazit të komprimuar tokësor në përputhje me dispozitat e këtij ligji kryen personi juridik, i cili posedon autorizim nga prodhuesi i aparateve ose pajisjes që e monton, që i plotëson kushtet hapësinore, materiale teknike, të sigurisë dhe kushtet në lidhje me personelin e montimit të aparateve.

(2) Personat juridikë për kryerjen e punëve për montimin e aparateve për motor me gaz të lëngët të naftës dhe motor me gaz të komprimuar tokësor, duhet të jenë të autorizuar me aktvendim të Ministrisë së Ekonomisë, me propozim për autorizim nga Inspektorati Shtetëror për Inspektim Teknik.

(3) Personi juridik nga paragrafi (2) i këtij neni për marrje të autorizimit paraqet kërkesë në Ministrinë e Ekonomisë.

(4) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (3) i këtij neni, dokumentacionin e nevojshëm shoqërues dhe shpenzimet për zbatimin e procedurës për autorizim i përcakton ministri i Ekonomisë.

(5) Personi juridik nga paragrafi (2) i këtij neni paguan shpenzime për zbatimin e procedurës, në përputhje me personelin e angazhuar dhe kohëzgjatjen e saj.

(6) Personi i autorizuar zyrtar nga Ministria e Ekonomisë, i cili e udhëheq procedurën me detyrë zyrtare, në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës, i siguron dëshmitë që janë në kompetencë të organit publik.

(7) Personi zyrtar i autorizuar nga organi publik kompetent detyrohet t'i paraqesë dëshmitë e kërkuara nga paragrafi (6) i këtij neni në Ministrinë e Ekonomisë në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës.

(8) Personi i autorizuar zyrtar nga Ministria e Ekonomisë i cili e udhëheq procedurën sipas detyrës zyrtare në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit të kërkesës, te Inspektorati Shtetëror i Inspeksionit Teknik dorëzon kopje të kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues për sigurimin e propozimit për autorizim nga paragrafi (2) i këtij neni.

(9) Personi zyrtari i autorizuar nga Inspektorati Shtetëror për Inspektim Teknik është i obliguar propozimin për autorizim ta dorëzojë në Ministrinë e Ekonomisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (8) i këtij neni.

(10) Nëse propozimi për autorizim nga Inspektorati Shtetëror për Inspeksion Teknik është negativ, përkatësisht personi juridik nuk i plotëson kushtet në përputhje me rregullën e përcaktuar në nenin 11 paragrafi (1) alineja 14 të këtij ligji, Ministria e Ekonomisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit për autorizim nga paragrafi (9) i këtij neni, miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës për autorizim të personit juridik.

(11) Nëse propozimi për autorizim nga Inspektorati Shtetëror për Inspeksion Teknik është pozitiv, dhe personi juridik i plotëson kushtet në përputhje me rregullën e përcaktuar në nenin 11 paragrafi (1) alineja 14 të këtij ligji, Ministria e Ekonomisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të dëshmimeve të kërkuara nga paragrafi (7) dhe propozimin për autorizim nga paragrafi (9) i këtij neni, miraton aktvendim për autorizim të personit juridik për montimin e aparateve për motor për gaz të lëngët të naftës dhe të gazit të komprimuar tokësor.

(12) Kundër aktvendimit nga paragrafët (10) dhe (11) të këtij neni, mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(13) Ministria e Ekonomisë mban evidencë elektronike për aktvendimet e lëshuara nga paragrafët (10) dhe (11) të këtij neni.

(14) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë në denarë do të shqiptohet për kundërvajtje personit juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (2) të këtij neni.

(15) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik për kundërvajtjen e kryer nga paragrafi (14) i këtij neni.

(16) Gjobë në shumë prej 25 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar nga Ministria e Ekonomisë, në qoftë se me detyrë zyrtare nuk i siguron dëshmitë në afatin e dhënë në paragrafin (6) dhe nuk e siguron propozimin për autorizim për montimin e aparateve për motor me gaz të lëngët të naftës dhe / ose gazit të komprimuar tokësor në afatin e dhënë në paragrafin (8) të këtij neni.

(17) Gjobë në kundërvlerë prej 25 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje për personin zyrtar të autorizuar nga organi publik kompetent, nëse ai nuk i dorëzon dëshmitë e kërkuara në afat të përcaktuar në paragrafin (7) të këtij neni.

(18) Gjobë në shumë prej 25 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar nga Inspektorati Shtetëror për Inspeksion Teknik nëse nuk e dorëzon propozimin për autorizim për personin juridik nga paragrafi (2) i këtij neni, në afatin e përcaktuar në paragrafin (9) të këtij neni."

Neni 28

Neni 56 ndryshon si vijon:

"Autorizimi për shërbim teknik

"(1) Punët e shërbimeve teknike i kryejnë persona juridikë të autorizuar me aktvendim të Ministrisë së Ekonomisë me propozim për autorizim për shërbimin teknik nga organi i miratimit dhe në bazë të certifikatës së lëshuar për akreditim nga organi për vlerësimin e kompetencës.

(2) Certifikata për akreditim dhe shtojca e saj duhet ta definojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar kapacitetin dhe fushën e kompetencave të shërbimit teknik, përkatësisht kuadrin, rregullat, standardet dhe kërkesat teknike që zbatohen, si dhe në lidhje me kategorinë dhe llojit e automjeteve, sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive teknike të pavarura të cilave u përkasin, e në përputhje me kërkesat e nenit 58 të këtij ligji.

(3) Propozimin për autorizim për shërbimin teknik nga organi për miratim nga paragrafi (1) i këtij neni, organi për miratim duhet ta miratojë në bazë të vlerësimeve relevante dhe shqyrtimeve përkatëse në lidhje me përmbajtjen e certifikatës së akreditimit dhe shtojcës së tij dhe shqyrtimin për kapacitetin dhe rezultatet e aktiviteteve të mëparshme të personave juridikë nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Personi juridik nga paragrafi (1) i këtij neni për marrjen e autorizimit për shërbim teknik paraqet kërkesë të veçantë në Ministrinë e Ekonomisë, për çdo vend të provimit.

(5) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (4) i këtij neni, dokumentacionin e nevojshëm shoqëruar dhe shpenzimet për zbatimin e procedurës për autorizim i përcakton ministri i Ekonomisë.

(6) Personi juridik nga paragrafi (1) i këtij neni i paguan shpenzimet për zbatimin e procedurës, në përputhje me personelin e angazhuar dhe kohëzgjatjen e procedurës.

(7) Personi i autorizuar zyrtar nga Ministria e Ekonomisë, i cili e udhëheq procedurën sipas detyrës zyrtare, në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës, dorëzon kërkesë për dëshmitë që janë në kompetencë të organit publik.

(8) Personi zyrtar i autorizuar nga organi publik kompetent detyrohet që dëshmitë e kërkuara nga paragrafi (7) i këtij neni t'i dorëzojë në Ministrinë e Ekonomisë në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës.

(9) Personi zyrtar i autorizuar nga Ministria e Ekonomisë i cili e udhëheq procedurën, në qoftë se konstaton se dokumentacioni i paraqitur është i kompletuar, sipas detyrës zyrtare, në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit të provave të kërkuara nga paragrafi (8) i këtij neni, është i detyruar t'i dorëzojë organit të miratimit një kopje të kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese.

(10) Organi për miratim nga dita e pranimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga paragrafi (4) i këtij neni, në afat prej 10 ditëve, kryen mbikëqyrje tek personi juridik nëpërmjet Komisionit për Mbikëqyrje, me qëllim që të verifikohet nëse janë plotësuar kushtet për marrjen e Propozimit për autorizim për shërbim teknik.

(11) Komisionin për mbikëqyrje nga paragrafi (10) i këtij neni e formon drejtori i organit miratues, i cili përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë, prej të cilëve njëri anëtar është nga Ministria e Ekonomisë.

(12) Pas kryerjes së mbikëqyrjes së Komisionit për Mbikëqyrje, organi i miratimit do të përgatisë Propozim për autorizim për shërbim teknik dhe personi zyrtar i autorizuar nga organi për miratim do ta dorëzojë në Ministrinë e Ekonomisë në afat prej 15 ditësh pune nga dita e pranimi të kërkesës nga paragrafi (7) të këtij neni.

(13) Nëse propozimi për autorizim për shërbim teknik nga organi për miratim është negativ, ose personi juridik nuk i plotëson kushtet në përputhje me rregullën e përcaktuar në nenin 11 paragrafi (1), alinetë 1, 2, 3, 4 dhe 6 të këtij ligji, Ministria e Ekonomisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së dëshmime të kërkuara nga paragrafi (8) dhe propozimit për autorizim për shërbim teknik nga paragrafi (12) i këtij neni, miraton aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa për autorizimin e personit juridik për shërbim teknik.

(14) Nëse propozimi për autorizim për shërbim teknik nga organi për miratim është pozitiv, ndërsa personi juridik i plotëson kushtet në tërësi në përputhje me rregullën e përcaktuar në nenin 11 paragrafi (1), alinetë 1, 2, 3, 4 dhe 6 të këtij ligji, Ministria e Ekonomisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së dëshmime të kërkuara nga paragrafi (8) dhe propozimin për autorizim për shërbim teknik nga paragrafi (12) i këtij neni, miraton vendimin me të cilin refuzohet kërkesa për autorizimin e personit juridik për shërbim teknik.

(15) Kundër aktvendimit nga paragrafët (13) dhe (14) të këtij neni, mund të iniciohet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(16) Ministria e Ekonomisë mban regjistër elektronik për aktvendimet e lëshuara nga paragrafët (13) dhe (14) të këtij neni.

(17) Gjobë në shumë prej 25 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar të organit publik kompetent, nëse nuk i dorëzon dëshmitë e kërkuara në afat të përcaktuar në paragrafin (7) të këtij neni.

(18) Gjobë në shumë prej 25 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar të Ministrisë së Ekonomisë, nëse nuk e kërkon sipas detyrës zyrtare dëshminë në afat të caktuar në paragrafin (7) dhe nëse me detyrë zyrtare në afatin e dhënë nuk dorëzon kopje të kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues nga paragrafi (9) i këtij neni.

(19) Gjobë në shumë prej 25 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar nga organi kompetent publik, nëse sipas detyrës zyrtare në afat të caktuar nuk dorëzon kopje të kërkesës me dokumentacion shoqërues nga paragrafi (8) i këtij neni.

(20) Gjobë në shumë prej 25 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar të organit për miratim, nëse nuk e dorëzon propozimin për autorizim për shërbim teknik në afat të përcaktuar në paragrafin (12) të këtij neni.

(21) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik që kryen punë pa autorizim nga paragrafi (1) i këtij neni.

(22) Gjobë në shumë prej "500 euro në kundërvlerë me denarë"do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik për kundërvajtjen e kryer nga paragrafi (21) i këtij neni."

Neni 29

Neni 56-a ndryshon si vijon:

"Autorizimi i shërbimit teknik për inspeksion dhe dhënia e certifikatës ADR

(1) Inspeksion dhe lëshim të certifikatës ADR për automjetet e miratuara më parë për transportimin e materieve të rrezikshme, në lidhje me dispozitat e nenit 18 paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji, mund të kryejë shërbimi teknik që është i autorizuar të kryejë miratimin individual të automjeteve për qëllime të veçanta për transportin e mallrave të rrezikshme, në përputhje me nenin 17 paragrafi (3) alineja 2 dhe neni 18 paragrafi (2) të këtij ligji, nëse është

autorizuar me aktvendim nga Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të certifikatës së lëshuar për akreditim për inspektimin e automjeteve për transportin e materieve të rrezikshme, sipas marrëveshjes ADR, të lëshuar nga organi për vlerësimin e kompetencës.

(2) Shërbimi teknik nga paragrafi (1) i këtij neni për marrjen e autorizimit për inspektim dhe lëshimin e certifikatës ADR për automjetet e miratuara paraprakisht për transportin e mallrave të rrezikshme paraqet kërkesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

(3) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, dokumentacionin e nevojshëm shoqërues dhe lartësinë e shpenzimeve në procedurë i përcakton ministri i Ekonomisë.

(4) Shërbimi teknik nga paragrafi (1) i këtij neni i paguan shpenzimet për zbatimin e procedurës për autorizim, në përputhje me personelin e angazhuar dhe kohëzgjatjen e të njëjtës.

(5) Me kërkesën nga paragrafi (2) i këtij neni shërbimi teknik te Ministria e Punëve të Brendshme i dorëzon këto dëshmi:

- aktvendim për autorizim të një shërbimi teknik për miratimin e veturave individualisht për qëllime të posaçme për transportin e mallrave të rrezikshme, të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë,

- aktvendim për autorizim për kryerjen e punëve të kontrollit teknik të automjeteve të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, përveç institucionit hetimor shkencor në fushën e automjeteve,

- certifikatë për akreditimit me Shtojcën e certifikatës së akreditimit për trupin inspektues, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter,

- gjendjen rrjedhëse, të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut,

- dëshmi për kuadrin e punësuar profesionistë se ai është i punësuar për kohë të caktuar ose të pacaktuar me orar të plotë dhe dëshmi për përgatitjen e tyre profesionale,

- dëshmi për pronësi të hapësirës për kontroll teknik të automjeteve, përveç institucionit kërkimor shkencor në fushën e automjeteve ose marrëveshje për qira të të njëjtit, të verifikuar në noter me vlefshmëri prej së paku katër vjet, në përputhje me qëllimin dhe detyrat që do t'i kryejë personi juridik në atë mënyrë që hapësira nuk përdoret nga dy shërbime teknike,

- dëshmi për pajisje teknike, në pajtim me vëllimin dhe detyrat të cilat i kryen personi juridik,

- dëshmi për marrëveshje të lidhur për sigurim me përgjegjësi profesionale,

- raport për bonitet pozitiv,

- dëshmi për taksë të paguar administrative në pajtim me Ligjin për taka administrative dhe

- dëshmi për shpenzimet e paguara për zbatimin e procedurës për marrjen e autorizimit.

(6) Personi zyrtar i autorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, i cili e udhëheq procedurën, sipas detyrës zyrtare, në afat prej shtatë ditëve të punës nga dita e pranimit të kërkesës i siguron dëshmitë nga paragrafi (5) alinetë 4 dhe 9 të këtij neni.

(7) Personi zyrtar i autorizuar nga organi kompetent publik është i obliguar që dëshmitë e kërkua nga paragrafi (5) alinetë 4 dhe 9 të këtij neni t'i dorëzojë në Ministrinë e Punëve të Brendshme në afat prej shtatë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës.

(8) Për marrjen e autorizimit nga paragrafi (1) i këtij neni personi juridik duhet t'i plotësojë kushtet të cilat kanë të bëjnë me:

- autorizim për kryerjen e punëve të shërbimit teknik për miratimin e vetëm të automjeteve për dedikim special për transportin e materieve të rrezikshme dhe autorizimin për kryerjen e punëve për kontroll teknike të automjeteve;

- certifikatë për akreditim;

- kuadër adekuat profesional (udhëheqës dhe së paku dy punëtorë profesionistë),

- pajisje të nevojshme dhe aparate;

- hapësirë adekuate (stacion për kontroll teknik) dhe

- sigurim nga përgjegjësia profesionale.

(9) Nëse shërbimi teknik nuk i plotëson kushtet e paragrafit (8) të këtij neni dhe dispozitat nga neni 67 paragrafi (1) alineja 8 e këtij ligji, Ministria e Punëve të Brendshme në afat prej 60 ditëve nga dita e pranimit të provave të kërkuara nga paragrafi (5) i këtij neni, miraton aktvendim me të cilin e refuzon kërkesën e shërbimit teknik.

(10) Nëse shërbimi teknik nuk i plotëson kushtet nga paragrafi (8) i këtij neni dhe dispozitat nga neni 67 paragrafi (1) alineja 8 të këtij ligji, Ministria e Punëve të Brendshme në afat prej 60 ditëve nga dita e pranimit të provave të kërkuara nga paragrafi (5) i këtij neni, miraton aktvendim për autorizim të shërbimit teknik të kryej inspektim dhe dhënie të certifikatës ADR të automjeteve të miratuara paraprakisht për transportin e materieve të rrezikshme.

(11) Kundër aktvendimit nga paragrafët (9) dhe (10) të këtij neni, mund të ngrihet kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(12) Ministria e Punëve të Brendshme mban regjistër elektronik për vendimet e lëshuara nga paragrafët (9) dhe (10) të këtij neni.

(13) Gjobë në shumë prej 50 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nëse nuk i kërkon dëshmitë me detyrë zyrtare në afatin e përcaktuar në paragrafin (6) të këtij neni.

(14) Gjobë në shumë prej 50 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar të organit publik kompetent, nëse nuk i dorëzon dëshmitë e kërkuara në afatin e përcaktuar në paragrafin (7) të këtij neni.

(15) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shërbimit teknik që kryen punë pa autorizim nga paragrafi (1) i këtij neni.

(16) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë” do t'i shqiptohet personit përgjegjës të shërbimi teknik për kundërvajtjen e kryer nga paragrafi (15) i këtij neni.”.

Neni 30

Në nenin 57 paragrafi (1) në alinenë 5 lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje.

Në alinenë 6 pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohet aline e re 7 si vijon:

"- përcakton kategorinë ekologjike të automjeteve dhe i shënon me etiketë ekologjike."

Në paragrafin (4) fjalët: "alinetë 1, 3 dhe 4" zëvendësohen me fjalët: "alinetë 1, 3, 4 dhe 7".

Neni 31

Në nenin 58 paragrafi (3) ndryshon si vijon:

"Shërbimet teknike nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni duhet t'i plotësojnë koto standarde:

- Kategorija A - MKS EN ISO/IEC 17025 lidhur me kërkesat e përgjithshme për kompetencën e laboratorëve për analizë dhe kalibrim,

- Kategorija B - MKS EN ISO/IEC 17020 lidhur me kriteret e përgjithshme të punës së tipave të ndryshme të organeve të cilët kryejnë kontroll,

- Kategorija C - MKS EN ISO/IEC 17021 lidhur me kërkesat e përgjithshme për organet që punojnë vlerësim dhe certifikim / regjistrim të sistemeve për kualitet dhe

- Kategorija D - MKS EN ISO/IEC 17020 lidhur me kriteret e përgjithshme të punës së llojeve të ndryshme të organeve të cilët kryejnë kontroll.”.

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

"(4) Shërbimi teknik i cili kryen punë në:

- procedura për miratimin nacional të tipit të serive të vogla në pajtim me nenin 10 të këtij ligji;

- miratim individual të automjeteve në pajtim me nenet 17 dhe 18 të këtij ligji dhe miratim në faza në pajtim me nenin 18 të këtij ligji,

- miratim të automjeteve nga seria përmbyllëse dhe automjete, sisteme, pjesë përbërëse ose njësisive të pavarura teknike të përpunuara sipas teknologjive ose parimeve të veçanta, në përputhje me nenin 10 të këtij ligji,

- miratim të automjeteve për dedikim special për transportin e materieve të rrezikshme, lidhur me dispozitat e nenit 18 paragrafët (2), (3) dhe (4),
- punë sipas specifikave të caktuara teknike në pajtim me nenin 57 paragrafi (3) të këtij ligji dhe
- miratim të modifikimit dhe riparimit në pajtim me nenin 19 të këtij ligji, duhet të disponojë hapësirë adekuate, pajisje, aparate dhe personel dhe të tregojë shkathtësi adekuate, njohuri specifike teknike dhe eksperiencë të dëshmuar specifike, në veçanti për secilën nga punët në alinetë e këtij paragrafi. Hapësira, pajisjet, aparatet dhe personeli me aftësitë e tyre specifike, njohuritë në fusha specifike dhe përvojën e dëshmuar, duhet të mundësojnë analiza inxhinierie, vlerësime inxhinierie, llogaritje, zbatimin e procedurave alternative dhe virtuale të testimit me qëllim që të sigurohet një nivel i duhur i sigurisë së automjeteve për pjesëmarrjen në komunikacionin rrugor dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, në masën më të madhe të mundshme, në veçanti për të gjitha fushat dhe kërkesat teknike në kuadër të punëve të veçanta të alinesë të këtij paragrafi.”.

Neni 32

Në nenin 59 paragrafi (1) fjala "kontroll" zëvendësohet me fjalën "aktivitete".

Paragrafi (3) ndryshon si vijon:

"Akreditimi i shërbimit teknik që kryen punë në:

- procedurën e miratimit nacional të tipit të serive të vogla në pajtim me nenin 10 të këtij ligji,
- miratim të veçantë i automjeteve në pajtim me nenet 17 dhe nenin 18 të këtij ligji,
- miratim në faza në pajtim me nenin 18 të këtij ligji dhe punë në fazën e fundit nga miratimi i më shumë fazave të tipit,
- miratim të automjeteve nga seri përmyllëse dhe automjete, sisteme, pjesë përbërëse ose njësi të veçanta teknike të përpunuara sipas teknologjive ose parimeve të veçanta, në përputhje me nenin 10 të këtij ligji,
- miratim të automjeteve për dedikim special për transportin e materieve të rrezikshme, lidhur me dispozitat e nenit 18 paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji,
- për inspektimin e automjeteve për transportin e materieve të rrezikshme në pajtim me marrëveshjen ADR,
- miratim të automjeteve për transportin e prodhimeve ushqimore që prishen lehtë në përputhje me Marrëveshjen për transport ndërkombëtar të prodhimeve ushqimore që prishen lehtë dhe pajisjet e automjeteve speciale për transportin e tyre (ATP), në përputhje me dispozitat e nenit 18 paragrafi (2) të këtij ligji,
- punë sipas specifikave të caktuara teknike, në pajtim me nenin 57 të këtij ligji dhe
- miratim i modifikimeve dhe riparimeve në pajtim me nenin 19 të këtij ligji, kryhet në pajtim me nenin 58 paragrafi (4) të këtij ligji dhe rregullat e veçanta për aktivitetet e theksuara, të miratuara në bazë të këtij ligji.”.

Neni 33

Në nenin 60 në paragrafin (2) fjala "ministri" zëvendësohet me fjalën "Ministria".

Neni 34

Neni 62 ndryshon si vijon:

"Autorizimi i Ministrisë së Ekonomisë

(1) Personi juridik për kontroll teknik të automjeteve, për të kryer punë për identifikimin dhe identifikimin dhe vlerësimin e gjendjes teknike të automjeteve, duhet të autorizohet me aktvendim të Ministrisë së Ekonomisë.

(2) Për marrjen e autorizimit nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik për kryerjen e kontrollit teknik të automjetit paraqet kërkesë në Ministrinë e Ekonomisë.

(3) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, dokumentacionin e nevojshëm shoqërues dhe lartësinë e shpenzimeve në procedurë i përcakton ministri i Ekonomisë.

(4) Personi juridik nga paragrafi (1) i këtij neni i paguan shpenzimet për zbatimin e procedurës, në përputhje me personelin e angazhuar dhe kohëzgjatjen e të njëjtës.

(5) Personi i autorizuar zyrtar nga Ministria e Ekonomisë, i cili e udhëheq procedurën sipas detyrës zyrtare në afat prej tri ditësh pune nga dita e marrjes së kërkesës, dorëzon kërkesë për dëshmitë që janë në kompetencë të organit publik.

(6) Personi zyrtar i autorizuar nga organi publik kompetent duhet t'i dorëzojë dëshmitë e kërkuara nga paragrafi (5) i këtij neni në Ministrinë e Ekonomisë në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit të kërkesës.

(7) Në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të dëshmimeve nga paragrafi (6) i këtij neni, Ministria e Ekonomisë kryen këqyrje të menjëhershme të personi juridik nga paragrafi (1) i këtij neni dhe për këqyrjen e kryer përpilohet procesverbal.

(8) Nëse personi juridik nuk i plotëson kushtet e parashikuara nga dispozitat e rregullores së përcaktuar në nenin 11 paragrafi (1) alineja 2 dhe kriteret e përcaktuara në nenin 67 paragrafi (2) të këtij ligji, Ministria e Ekonomisë, në afat prej shtatë ditësh nga dita e përpilimit të procesverbalit nga paragrafi (7) i këtij neni, miraton aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa për autorizimin e personit juridik për kontroll teknik të automjeteve.

(9) Nëse personi juridik i plotëson kushtet e parashikuara nga dispozitat e rregullores së përcaktuar në nenin 11 paragrafi (1) alineja 2 dhe kriteret e përcaktuara në nenin 67 paragrafi (2) të këtij ligji, Ministria e Ekonomisë në afat prej shtatë ditësh nga dita përpilimit të procesverbalit nga paragrafi (7) i këtij neni, miraton aktvendim për autorizimin e personit juridik për kontroll teknik të automjeteve të kryej punë për identifikim dhe identifikimin dhe vlerësimin e gjendjes teknike të automjeteve.

(10) Kundër vendimit nga paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, mund të ngrihet kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(11) Personi juridik për kontroll teknik nuk mund të kryejë identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjeteve të veta.

(12) Ministria e Ekonomisë mban regjistër elektronik për aktvendimet e lëshuara nga paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni.

(13) Gjobë në shumë prej 25 euro në kundërvlerë në detarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar të Ministrisë së Ekonomisë, nëse nuk e kërkon sipas detyrës zyrtare dëshminë në afatin e dhënë në paragrafin (5) të këtij neni.

(14) Gjobë në shumë prej 25 euro në kundërvlerë në detarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar të organit publik kompetent, nëse nuk i dorëzon dëshmitë e kërkuara në afat të përcaktuar në paragrafin (6) të këtij neni.

(15) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik që kryen punë pa autorizim nga paragrafi (1) i këtij neni.

(16) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personit juridik për kundërvajtjen e kryer nga paragrafi (15) i këtij neni.”.

Neni 35

Neni 62-a ndryshon si vijon:

“Autorizimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme

(1) Personat juridikë që të kryejnë punë të kontrollit teknik të automjeteve duhet të jenë të autorizuar me aktvendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

(2) Për marrje të autorizimit nga paragrafi (1) i këtij neni, personi juridik parashtron kërkesë për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

(3) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës së paragrafit (2) i këtij neni, dokumentacionin e nevojshëm përcjellës dhe lartësinë e shpenzimeve në procedurë i përcakton ministri i Punëve të Brendshme.

(4) Personi juridik nga paragrafi (1) i këtij neni paguan shpenzime për zbatimin e procedurës, në pajtim me personelin e angazhuar dhe kohëzgjatjen e të njëjtës.

(5) Me kërkesën nga paragrafi (2) i këtij neni personi juridik i Ministrisë së Punëve të Brendshme i dorëzon këto dëshmi:

- aktvendimi regjistrimi dhe gjendja rrjedhëse e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut me veprim me prioritet - kontrollin teknik dhe analizën,

- për kuadrin profesional se janë të punësuar për kohë të caktuar ose të pacaktuar me orar të plotë pune, përgatitje profesionale, provim të specializuar, përvojë pune, patentë shoferi për së paku prej kategorisë "B" dhe licenca për punë,

- për pronësinë e hapësirës për kontroll teknik të automjeteve ose marrëveshje për qira të hapësirën për kontroll teknik të automjeteve, të verifikuara në noter me vlefshmëri prej së paku katër vjetësh, në pajtim me vëllimin dhe detyrat të cilat do t'i kryej personi juridik, në mënyrë që hapësira nuk shfrytëzohet nga dy ose më shumë persona juridikë për kryerjen e kontrollit teknik,

- objekti për kontroll teknik të automjeteve nga neni 64 i këtij ligji të mos jetë i përdorur nga personi juridik të cilit i është hequr autorizimi për kryerjen e kontrollit teknik të automjeteve në tre vjetët e fundit, llogaritur nga dita e dorëzimit të kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni,

- për pajisjet teknike për kryerjen e kontrollit teknik të automjeteve, personal ose marrëveshje për qira, në mënyrë që pajisja nuk shfrytëzohet nga dy ose më shumë persona juridikë për kryerjen e kontrollit teknik, në pajtim me vëllimin dhe detyrat që do t'i kryejë personi juridik,

- për marrëveshje të lidhur për sigurimin e përgjegjësisë profesionale,

- raport për bonitet pozitiv, kurse për personin juridik që është deklarata e sapoformuar e personit përgjegjës në person juridik, se në afat prej gjashtë muajsh, llogaritur nga dita e lëshimit të aktvendimit për autorizim, do të dorëzojë dëshmi për bonitet pozitiv,

- për takstë administrative të paguar në pajtim me Ligjin për taksa administrative dhe

- për shpenzime të paguara për zbatim të procedurës për marrje të autorizimit.

(6) Personi zyrtar i autorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, i cili e udhëheq procedurën, sipas detyrës zyrtare, në afat prej shtatë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës, i siguron dëshmitë nga paragrafi (5) alinetë 1 dhe 6 të këtij neni.

(7) Personi zyrtar i autorizuar nga organi publik kompetent është i detyruar dëshmitë e kërkuara nga paragrafi (6) i këtij neni t'i dorëzojë në Ministrinë e Punëve të Brendshme në afat prej pesë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës.

(8) Nëse personi juridik nuk i plotëson kërkesat dhe nuk i zbaton procedurat e parapara me dispozitat e rregullës nga neni 48 paragrafi (1) alinetë 3 dhe 5 dhe kriteret dhe procedurat e përcaktuara në nenin 67 paragrafi (1) alineja 1 dhe 2 të këtij ligji, Ministria e Punëve të Brendshme në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të dëshmimeve të kërkuara nga paragrafi (5) i këtij neni, miraton aktvendim me të cilin e refuzon kërkesën e personit juridik.

(9) Nëse personi juridik i plotëson kërkesat dhe nuk i zbaton procedurat e parapara me dispozitat e rregullës nga neni 48 paragrafi (1) alinetë 3 dhe 5 dhe kriteret dhe procedurat e përcaktuara në nenin 67 paragrafi (1) alinetë 1 dhe 2 të këtij ligji, Ministria e Punëve të Brendshme në afat prej 90 ditësh nga dita e pranimit të dëshmimeve të kërkuara nga paragrafi (5) i këtij neni, miraton aktvendim për autorizim të personit juridik të kryejë punë të kontrollit teknik të automjeteve.

(10) Kundër aktvendimit nga paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(11) Ministria e Punëve të Brendshme mban evidencë elektronike për aktvendimet e lëshuara nga paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni.

(12) Personi juridik për kontroll teknik nuk mund të kryejë kontroll teknike të automjeteve të veta.

(13) Gjobë në shumë prej 50 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, nëse nuk i kërkon dëshmitë sipas detyrës zyrtare në afat të përcaktuar në paragrafin (6) të këtij neni.

(14) Gjobë në shumë prej 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga organi publik kompetent, nëse nuk i dorëzon dëshmitë e kërkuara në afat të përcaktuar në paragrafin (7) të këtij neni.

(15) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik që kryen punë pa autorizim nga paragrafi (1) i këtij neni.

(16) Gjobë në shumë 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (15) i këtij neni.”.

Neni 36

Në nenin 63 në paragrafin (2) fjalët: “grup i kategorive” zëvendësohen me fjalën “kategori”.

Neni 37

Neni 64 ndryshohet si vijon:

“(1) Për marrje të autorizimit nga neni 63 i këtij ligji, personi juridik, veçmas për secilin stacion për kontroll teknik, duhet t'i plotësoj kushtet të cilat kanë të bëjnë me:

- objekt me dedikim – stacion për kontroll teknik të automjeteve,
- kuadër profesional përkatës, udhëheqës dhe së paku dy punëtorë profesionistë të punësuar me kohë të caktuar ose të pacaktuar me orar të plotë pune,
- pajisje, aparate dhe hapësira të nevojshme dhe
- sigurim nga përgjegjësia profesionale.

(2) Autorizimi nga paragrafi (1) i këtij neni lëshohet veçmas për secilin stacion për kontroll teknik të automjeteve.”.

Neni 38

Në nenin 65 paragrafin (2) në fjalinë hyrëse, fjala “Ministri” zëvendësohet me fjalën “Ministria”, kurse fjala “ministri” zëvendësohet me fjalën “Ministria”.

Në alinenë 2 fjalët: “alineja 6” zëvendësohen me fjalët: “alineja 11”.

Pas alinesë 2 shtohen tri aline të reja 3, 4 dhe 5 si vijojnë:

- nuk kryen matje të emisionit të gazrave të nxjerra ose shkresa nga vlerat e matura të emisioneve të gazrave të nxjerra të automjeteve nuk e bashkëngjit në listën e regjistrimit për automjetin,

- nuk kryen matje dhe regjistrim të vlerave të matura për korrektësinë teknike të sistemit të frenimit të automjetit nuk e bashkëngjit në listën e regjistrimit të automjetit,

- nuk bën matjen dhe regjistrimin e vlerave të matura për rregullsinë teknike të sistemit për drejtim të automjetit nuk e bashkëngjit në listën e regjistrimit për automjetin.”.

Në paragrafin (3), pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: “në afatin e caktuar prej 30 ditësh, personi juridik nuk mund të kryejë kontroll teknik të automjeteve.”.

Në paragrafin (4) fjala “ministri” zëvendësohet me fjalën “Ministria”.

Në paragrafin (5) fjalët: “i hiqet” zëvendësohen me fjalët: “Ministria e Ekonomisë do t'ia heqë”.

Pas paragrafit (5) shtohen katër paragrafë të rinj (6), (7), (8) dhe (9) si vijojnë:

"(6) Nëse gjatë mbikëqyrjes nga neni 77 paragrafi (2) të këtij ligji përcaktohet se personi juridik për kryerjen e kontrollit teknik, i cili është i autorizuar të kryejë identifikim dhe identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjeteve, punët nuk i kryen në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e miratuara në këtë ligj, Ministria e Ekonomisë me aktvendim do t'ia revokojë autorizimin për kryerjen e identifikimit dhe identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes teknike të automjeteve.

(7) Gjobë në shumë prej 5.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit juridik të autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (1), (2) alinetë 1,2,3,4,5 dhe 9 dhe paragrafi (3) i këtij neni.

(8) Gjobë në shumën prej "500 euro në kundërvlerë me denarë" do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik i autorizuar për kontroll teknik, i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (7) të këtij neni.

(9) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje udhëheqësit dhe punëtorit profesional i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (1), (2) alinetë 1, 2, 3, 4, 5 dhe 9 dhe (3) të këtij neni."

Paragrafët (6) dhe (7) shlyhen.

Në paragrafin (8) i cili bëhet paragraf (10) fjalët: "(2) dhe (3)" zëvendësohen me fjalët: "(2), (3), (5) dhe (6)".

Neni 39

Pas nenit 65 shtohet neni i ri 65-a si vijon:

"Neni 65-a

(1) Nëse në kohën e ndalimit nga neni 65 paragrafi (3) të këtij ligji, Ministria e Punëve të Brendshme përcakton se personi juridik i autorizuar kryen kontroll teknik të automjeteve, me aktvendim do t'ia heqë autorizimin për kryerjen e kontrollit teknik të automjeteve.

(2) Përveç heqjes së autorizimit personit juridik për kryerjen e kontrollit teknik të automjeteve nga paragrafi (1) i këtij neni, do t'i hiqet licenca e udhëheqësit dhe punëtorëve profesionistë në stacionin për kontroll teknik.

(3) Gjobë në shumë prej 5.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik të autorizuar për kryerje të kontrollit teknik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik i autorizuar për kontroll teknik, i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (3) të këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 250 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje udhëheqësit dhe punëtorit profesionist i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni."

Neni 40

Në nenin 66 në paragrafin (1) pas fjalëve: "për realizimin e punëve të" shtohen fjalët: "udhëheqës profesionist dhe punëtor profesionist për".

Pas paragrafit (10) shtohen dy paragrafë të rinj (11) dhe (12) si vijojnë:

"(11) Për lejet e lëshuara nga paragrafi (3) i këtij neni, Ministria e Punëve të Brendshme mban evidencë të licencave të lëshuara dhe të hequra të punëtorëve profesionistë të cilët kryejnë kontroll teknik të automjeteve.

(12) Evidenca me të dhëna nga paragrafi (11) të këtij neni ruhet 15 vjet."

Neni 41

Në nenin 66-j në paragrafin (1) fjalët: “60 minuta.” zëvendësohen me fjalët: “90 minuta.”.

Neni 42

Në nenin 66-ll në paragrafin (8) fjala “Ministri” zëvendësohet me fjalën “Ministria”.

Në nenin (9) fjala “Ministri” zëvendësohet me fjalën “Ministria”.

Paragrafët (11) dhe (12) shlyhen.

Neni 43

Në nenin 67 paragrafin (1) në alinenë 4 fjalët: “grupe të ” shlyhen.

Pas alinesë 7 shtohen tri aline të reja 8, 9 dhe 10 si vijojnë:

"- kushtet më të afërta që duhet të plotësojnë shërbimet teknike për lejimin individual të automjeteve për dedikim të posaçëm për transportin e materieve të rrezikshme që kryejnë punë të inspektimit dhe lëshimit të certifikatave ADR të automjeteve të miratuara paraprakisht për transport të materieve të rrezikshme, evidenca që duhet t'i mbajnë për inspektimin e kryer dhe lëshimin e certifikatës ADR, mënyrën dhe procedurën për lëshimin e certifikatës ADR, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës ADR,

- forma e evidencës dhe përmbajtjes së licencave të lëshuara dhe të hequra të punëtorëve profesionistë të cilët kryejnë kontroll teknik të automjeteve,

- mënyra e mbajtjes së evidencave për kontrollin teknik të kryer të automjeteve,".

Në nenin (2) në alinenë 4 fjalët: “grupe të ” shlyhen.

Neni 44

Neni 73 ndryshohet si vijon:

"Regjistri i automjeteve

(1) Ministria e Punëve të Brendshme mban Regjistër të automjeteve që ka për qëllim të mundësojë të vendoset sistem i harmonizuar për këmbim të të dhënave ndërmjet subjekteve nga fusha e automjeteve për: miratim, lëshim në treg, kontroll teknik, regjistrim dhe lëshim në qarkullim në komunikacion rrugor, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore nga fusha e automjeteve, që përmban të dhëna për:

- tipat e lejuara të automjeteve (numri dhe data e lejimit të tipit të automjetit, të dhëna për automjetin: marka, tipi, fuqia e motorit, varianti dhe versioni i automjetit, tipi i motorit, përfshirja e motorit, karburanti, parashtruesi i kërkesës për lëshimit të lejes dhe titulli i personit juridik me NUAS të cilit i është lejuar tipi i automjetit),

- vërtetimet e lëshuara për përputhshmëri për automjet individual të lejuar, pëlqime për regjistrim, matricë për vlerësim të shmangies së kritereve që duhet t'i plotësojë automjeti për të fituar status të automjetit me vlerë historike, status i automjetit me vlerë historike, vërtetim për të dhëna për automjetin me vlerë historike, vërtetime për përputhshmëri të automjeteve të modifikuara dhe të ndrequra, ADR certifikatë (të dhëna për automjetin: numër i shasisë, marka, tipi/varianti/versioni i automjetit, tip i motorit, përfshirja e motorit, fuqia e motorit, karburanti, numri i motorit, të dhëna për pronarin e automjetit: emri dhe mbiemri me NUAQ ose titulli i personit juridik me NUAS, adresa dhe selia e pronarit të automjetit), vërtetim për kategorizim ekologjik të automjetit,

- lloji dhe shuma e pagesave dhe kompensimeve që paguhen gjatë procedurës për marrje të lejes së tipit dhe gjatë procedurës për marrje të lejes për automjet individual,

- leje për dhënie të shenjave identifikuese të automjetit (numër i shasisë dhe numër i motorit), (të dhëna të përmbajtura në leje, numri dhe data e dokumentit për automjetin motorik nga shërbimi teknik, marka, shenja komerciale e automjetit, tipi i automjetit dhe të dhëna për pronarin e automjetit);

- automjetet e regjistruara (numri i targës së regjistrimit, numër i targës testuese, numri serik i lejes për qarkullim, numri serik i vërtetimit për drejtim testues, të dhëna për markën e automjetit, tipi/varianti/versioni i automjetit, tipi i motorit, vëllimi i motorit, fuqia e motorit, nafta, numri i motorit dhe ngjyra e automjetit, të dhëna për pronarin ose shfrytëzuesin e automjetit: emri dhe mbiemri me NUAQ ose titulli i personit juridik me NUAS, adresa ose selia e pronarit ose shfrytëzuesit të automjetit),

- vërtetimet për karakteristika të përcaktuara minimale-teknike dhe eksploatuese për makina mobile (numri dhe data e vërtetimit, të dhëna për lëshuesin e vërtetimit, të dhëna nga vërtetimi për makinën mobile: marka, tipi/varianti/realizimi, shenja komerciale, numri i shasisë, viti i prodhimit, numër i certifikatës për përputhshmëri, tipi i motorit, vëllim i motorit, fuqia e motorit, karburanti, numri i motorit),

- historiku për pronarët e automjeteve (emri dhe mbiemri me NUAQ ose titulli i personit juridik me NUAS, adresa ose selia e pronarit të automjetit) dhe historiku i targave të regjistrimit që u janë dhënë për automjetet në pronësi të tyre,

- ndryshimet në pronësi të automjetit (targa të reja ose të vjetra, dëshmi për ndryshim të pronësisë, të dhëna për shfrytëzuesin e automjetit (emri dhe mbiemri me NUAQ ose titulli i personit juridik me NUAS, adresa ose selia e pronarit ose shfrytëzuesit të automjetit),

- automjetet të ç'lajmëruara, (të dhëna për automjetin motorik: numër i shasisë, tip i motorit, vëllim i motorit, fuqi e motorit, karburanti, numri i motorit dhe numri i regjistrimit),

- lloji dhe shuma e pagesave dhe kompensimeve që paguhën gjatë kontrollit teknik të automjeteve, numri i kilometrave të kaluara të automjetit dhe vërtetimi për rregullsi teknike të automjetit,

- automjetet e reja dhe të përdorura të importuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe për automjetet e eksportuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut (numri i targave të regjistrimit ose targave për test, numri i lejes për qarkullim, vërtetim për test drejtim, të dhëna për markën e automjetit, tipi/varianti/realizimi i automjetit, vëllimi i motorit, fuqia e motorit, karburanti, numri i shasisë, numri i motorit dhe ngjyra e automjetit),

- automjetet e shkatërruara (numri i targave të regjistrimit, numri i lejes për qarkullim, të dhëna për automjetin motorik: numri i shasisë, marka, tipi, varianti dhe versioni i automjetit, masa e automjetit dhe të dhëna për pronarin e automjetit),

- kontroll rrugor të rregullsisë teknike të automjeteve që qarkullojnë në komunikacionin rrugor (të dhëna për automjetin motorik - numri i shasisë, shenja të regjistrimit, numri i lejes për qarkullim, numri dhe data e procesverbalit për gjendje të konstatuar teknike të automjetit për kontroll të jashtëzakonshëm teknik të automjetit dhe të dhëna për personin e autorizuar për kryerje të kontrollit teknik),

- provimet e zbatuara profesionale (të dhëna për kontrollorin - emri dhe mbiemri, NUAQ, adresa, licenca të lëshuara për punë profesionale), të dhëna për personat që kanë qasje në rregullsinë teknike të automjeteve (emri dhe mbiemri, NUAQ, adresa dhe numri i licencës) dhe

- dëshmi për sigurim nga autopërgjegjësia (numri i policës, titulli i kompanisë së sigurimit, data dhe afati i sigurimit dhe përfshirja e sigurimit).

(2) Të dhënat nga paragrafi (1) alinetë 1, 2 dhe 3 të këtij neni në formë elektronike, i sigurojnë shërbimet e autorizuar teknike dhe janë të obliguara në nivel ditor të njëjtat t'i vendosin në Regjistrin e automjeteve.

(3) Të dhënat nga paragrafi (1) alineja 4 të këtij neni në formë elektronike i siguron organi për lejim të automjeteve dhe është i obliguar të njëjtat në nivel ditor t'i vendosë në Regjistrin e automjeteve.

(4) Të dhënat nga paragrafi (1) alinetë 5, 7, 8, 9, 13 dhe 14, të këtij neni i regjistron Ministria e Punëve të Brendshme dhe është e obliguar të njëjtat në nivel ditor t'i vendosë në Regjistrin e automjeteve.

(5) Të dhënat nga paragrafi (1) alineja 6 të këtij neni në formë elektronike i siguron, personi i autorizuar për kryerje kontrollit teknik të automjeteve i autorizuar për identifikim si dhe identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të makinave mobile ose shërbimi teknik i autorizuar të bëjë identifikim si dhe identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të makinave mobile dhe janë të obliguar të njëjtat t'i vendosin në Regjistrin e automjeteve.

(6) Të dhënat nga paragrafi (1) alineja 10 të këtij neni në formë elektronike i siguron, personi i autorizuar për kryerje kontrollit teknik të automjeteve dhe është i obliguar të njëjtat t'i vendosë në Regjistrin e automjeteve.

(7) Të dhënat nga paragrafi (1) alineja 11 të këtij neni në formë elektronike i siguron, Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e obliguar të njëjtat në nivel ditor t'i vendosë në Regjistrin e automjeteve.

(8) Të dhënat nga paragrafi (1) alineja 12 të këtij neni në formë elektronike i siguron, personi i autorizuar juridik për ndërmarrje të automjeteve të asgjësuar motorike është i obliguar të njëjtat në nivel ditor t'i vendosë në Regjistrin e automjeteve.

(9) Të dhënat nga paragrafi (1) alineja 15 të këtij neni në formë elektronike i siguron Byroja Nacionale për Sigurim dhe është i obliguar të njëjtat në nivel ditor t'i vendosë në Regjistrin e automjeteve.

(10) Gjobë në shumë prej 50 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga paragrafët (3), (4) dhe (7) të këtij neni, nëse në nivel ditor nuk janë vendosur të dhënat e kërkuara.

(11) Gjobë në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shërbimeve të autorizuar teknike, personit juridik të autorizuar për kontroll teknik të automjeteve, personit të autorizuar për kryerje të kontrollit teknik të automjeteve, personit të autorizuar juridik për ndërmarrje të automjeteve të asgjësuar, personit të autorizuar juridik për kryerje të kontrollit teknik të automjeteve të autorizuar për identifikim si dhe identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të makinave mobile, shërbimit teknik të autorizuar për identifikim si dhe identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të makinave mobile dhe Byrosë Nacionale për Sigurim nga paragrafët (2), (5), (6), (8) dhe (9) të këtij neni nëse në nivel ditor nuk janë vendosur të dhënat e kërkuara.

(12) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shërbimin teknik për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (11) i këtij neni.

(13) Të dhënat për automjetet të çregjistruara në Regjistrin e automjeteve ruhen 20 vite, llogaritur nga dita e çregjistrimit të automjetit.

Neni 45

Titulli para neni 73-a shlyhet.

Neni 46

Neni 73-a ndryshohet si vijon:

“Qasja te të dhënat në Regjistrin e automjeteve

Qasje tek të dhënat në Regjistrin e automjeteve nga neni 73 paragrafi (1) të këtij ligji mund të kenë: Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Byroja e Meteorologjisë, Drejtoria e të Ardhurave Publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Inspektorati Shtetëror për Transport, Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Byroja Nacionale për

Sigurim, shërbimet teknike, personat juridikë për kontroll teknik dhe personat juridikë për kontroll teknik të cilët janë të autorizuar për identifikim si dhe për identifikim dhe vlerësim të automjeteve dhe makinave mobile."

Neni 47

Nenet 73-b dhe 73-v shlyhen.

Neni 48

Titulli në nenin 74 ndryshohet si vijon:

"Të dhënat personale në Regjistrin e automjeteve"

Neni 49

Titulli në nenin 75 ndryshohet si vijon:

"Qasja në Regjistrin e automjeteve".

Neni 50

Neni 76 ndryshohet si vijon:

"Ministri i Punëve të Brendshme prej së afërmi i përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të automjeteve, kriteret për qasje kompjuterike në Regjistrin e automjeteve, si dhe mënyrën e vendosjes dhe qasjes të dhënat nga Regjistri i automjeteve në pajtim me nenet 73 dhe 75 të këtij ligji, masat organizative dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave personale të përfshira në Regjistrin e automjeteve në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale."

Neni 51

Në nenin 77 paragrafi (1) në alinenë 2 fjalët: "plotësimi i kushteve për punën e regjistrimit nga personat juridikë të automjeteve" zëvendësohen me fjalët: "lëshimi i vërtetimit për drejtim testues dhe targa testimi".

Neni 52

Në nenin 78 paragrafi (1) alineja 1 ndryshohet si vijon:

"- Inspektorati Shtetëror i Tregut mbi ligjshmërinë për lëshim vërtetimi për përputhshmëri nga përfaqësuesit e tyre, mbi punën e shërbimeve teknike, mbi punën e personave juridikë për kontroll teknik të automjeteve që i zbatojnë procedurat për identifikim si dhe identifikim dhe vlerësim të gjendjes teknike të automjeteve, si dhe mbi punën e personave që bëjnë përsosjen e aparateve për motor me gaz të naftës së lëngshme dhe motor të gazit të komprimuar tokësor."

Alineja 2 ndryshohet si vijon:

"- inspektorët ose personat e autorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme mbi punën e personave juridikë për kontroll teknik të automjeteve, persona juridikë që bëjnë inspektim dhe lëshim të ADR certifikatës, si dhe mbikëqyrjes së rregullsisë teknike të të gjitha automjeteve në komunikacionin rrugor."

Neni 53

Në nenin 79 paragrafi (1) shtohet pikë e re 1), si vijon:

"1) ta kontrollojë plotësimin e kushteve për kryerjen e punëve për shërbim teknik dhe kushteve për kryerjen e procedurave për identifikim dhe identifikim të vlerësimit të gjendjes teknike të automjeteve nga personat juridikë për kontroll teknik, të cilët janë të autorizuar për këtë;"

Në pikën 1) e cila bëhet pika 2) pas fjalëve: “që duhet ta mbajë” shtohen fjalët: shërbimi teknik dhe”.

Pikat 2), 3), 4), 5), 6), 7), 8) dhe 9) bëhen pika 3), 4), 5), 6), 7), 8), 9) dhe 10).

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Kundër çdo mase të ndërmarrë nga inspektori shtetëror i tregut nga paragrafi (1) i këtij neni mund të deklarohet ankesë në afat prej tetë ditësh te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse.”.

Paragrafi (3) shlyhet.

Neni 54

Në nenin 80 në paragrafin (2) fjalët:”komisioni i formuar nga ministri për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujërave” zëvendësohen me fjalët: "Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse”.

Paragrafi (3) shlyhet.

Neni 55

Titulli i nenit 81 ndryshohet si vijon:

“Mbikëqyrje të personave juridikë për kontroll teknik dhe personave juridikë të cilët lëshojnë vërtetim për drejtim testues dhe targa testuese”.

Në paragrafin (1) fjala “inspektues”, dhe fjalët: ”inspektori kompetent nga“ shlyhen.

Në pikën 1) pas fjalëve: ”kontrolle teknike” shtohen fjalët: ”dhe personi juridik i cili lëshon vërtetim për drejtim testues dhe targa testuese”.

Në pikat 2), 4) dhe 6) fjala “inspektuese” shlyhet.

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

“Kundër çdo mase të ndërmarrë gjatë mbikëqyrjes nga paragrafi (1) i këtij neni mund të inicohet kontest administrativ në gjykatën kompetente.”.

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

“Inicimi i kontestit administrativ në gjykatën kompetente, nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.”.

Neni 56

Në titullin e nenit 81-a pas fjalëve: “për punën e” shtohen fjalët: “udhëheqësit dhe”.

Në paragrafin (1) fjala “ministri” zëvendësohet me fjalën “Ministria”.

Në paragrafin (2) pas fjalëve: "aparate për drejtim" vendoset presje dhe shtohen fjalët: "të automjeteve që nuk i plotësojnë kërkesat në lidhje me cilësinë e emisionit të nxjerrë", fjala "ministër" zëvendësohet me fjalën "Ministria" dhe fjalët: "gjashtë muaj" zëvendësohen me fjalët: "një vit".

Në paragrafin (3) fjala “ministri” zëvendësohet me fjalën “Ministria”.

Pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4) si vijon:

"(4) Nëse punonjësi profesional konfirmon rregullsinë teknike të automjetit në kundërshtim me dispozitat e nenit 65 paragrafit (2) alinetë 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, Ministria e Punëve të Brendshme me aktvendim do t'ia heqë licencën për punë punonjësit profesional për periudhë prej një viti."

Në paragrafin (4), i cili bëhet paragraf (5), fjala "ministri" zëvendësohet me fjalën "Ministria" dhe shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Nëse udhëheqësi profesional urdhëron ose lejon të konfirmohet rregullsi teknike e automjetit mbi të cilin nuk është kryer kontroll teknik, konfirmon rregullsi teknike të automjetit me aparate të dëmtuara të frenimit, aparate për drejtim, automjete me aparat pa atest për gaz të lëngët të naftës, nuk është bërë matje e emisioneve të gazrave të nxjerra të motorit të automjetit

ose regjistrim i vlerave të matura të emisioneve të gazrave të nxjerra të motorit të automjetit nuk e bashkëngjit në fletën e regjistrimit për automjetin, Ministria e Punëve të Brendshme me aktvendim do t'ia heqë licencën e punës udhëheqësit profesionist për periudhë prej një viti. "

Në paragrafin (5) i cili bëhet paragraf (7) fjalët: “nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4)” zëvendësohen me fjalët: „nga paragrafët (1), (2), (3), (4), (5) dhe (6)”.

Në paragrafin (6), i cili bëhet paragraf (8), fjala "ministri" zëvendësohet me fjalën "Ministria".

Në paragrafin (7), i cili bëhet paragraf (9) numri “ 2.000” zëvendësohet me numrin “3.000”.

Paragrafi (8), i cili bëhet paragraf (10) ndryshohet si vijon:

“(10) Gjobë në shumë “500 euro në kundërvlerë me denarë” do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi i autorizuar juridik për kontroll teknik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (9) të këtij neni.”.

Pas paragrafit (10) shtohet paragrafi i ri (11) si vijon:

“(11) Gjobë në shumë prej 250 eurosh në kundërvlerë në denarë do të shqiptohet për kundërvajtje udhëheqësit dhe personave profesionistë për kontroll teknik te personi juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (2), (4) dhe (6) të këtij neni.”.

Neni 57

Titulli i nenit 81-b ndryshohet si vijon:

“Mbikëqyrja e shërbimit teknik të autorizuar për inspektim dhe lëshim të certifikatës ADR për automjetet e lejuara paraprakisht për transportin e mallrave të rrezikshme”.

Në paragrafin (1) fjalët: "person juridik i autorizuar për ekzaminim" zëvendësohen me fjalët: "shërbim teknik i autorizuar për inspektim dhe lëshim të certifikatës së ADR të automjeteve të lejuara paraprakisht për transportin e materieve të rrezikshme”.

Paragrafi 2) ndryshohet si vijon:

“Nëse personi i autorizuar zyrtar i Ministrisë së Punëve të Brendshme vërteton se shërbimi teknik i autorizuar për inspektimin dhe lëshimin e certifikatës ADR për automjet të lejuar për transport të materieve të rrezikshme, nuk i plotëson kushtet në lidhje me kushtet hapësinore, pajisjet, aparatet, kuadrot e nevojshme si dhe evidencat që mbahen në shërbimet teknike dhe nuk i kryen detyrat e caktuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji, Ministria e Punëve të Brendshme me aktvendim do t'i ndalojë kryerjen e punëve dhe do të përcaktojë afat prej 30 ditësh për mënjanimin e mangësive të identifikuara.”.

Pas paragrafit (3) shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5), si vijojnë:

“(4) Nëse punëtori profesionist në shërbimin teknik i autorizuar për inspektim dhe lëshim të certifikatës ADR për automjet të lejuar për transportin e materieve të rrezikshme vërteton rregullsinë teknike të automjetit pa kryer ekzaminim të automjetit për transportin e materieve të rrezikshme, Ministria e Punëve të Brendshme me aktvendim do t'ia heqë autorizimin.

(5) Nëse shërbimi i autorizuar teknik për lejim individual të automjeteve i hiqet autorizimi ose i shqiptohet masë e përkohshme ndalim i punës nga Ministria e Ekonomisë apo personit të autorizuar juridik për kryerje të kontrollit teknik i hiqet autorizimi ose do t'i shqiptohet masë e përkohshme ndalim nga Ministria e Punëve të Brendshme, në këtë rast me aktvendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme hiqet autorizimi përkatësisht shqiptohet masë e përkohshme ndalim i punës edhe shërbimit teknik të autorizuar për inspektimin dhe lëshimin e certifikatës ADR për automjet të lejuar për transportin e materieve të rrezikshme.”.

Në paragrafin (4) i cili bëhet paragraf (6) fjalët: “paragrafi 3” të zëvendësohen me fjalët: „paragrafët (2), (3), (4), dhe (5)”.

Pas paragrafit (6) shtohen pesë paragrafë të rinj (7), (8), (9), (10) dhe (11) si vijojnë:

“(7) Për inspektimin e kryer dhe lëshimin e certifikatës ADR për automjet të lejuar për transportin e materieve të rrezikshme, shërbimi teknik i autorizuar për inspektimin dhe lejimin e automjeteve për transportin e materieve të rrezikshme mban evidencë.

(8) Gjobë në shumë prej 4000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shërbimit teknik të autorizuar për inspektim dhe lëshim të certifikatës ADR për automjet të lejuar për transportin e materieve të rrezikshme në rast se i lejon punonjësit të kualifikuar të kryejë punë në shërbimin teknik të autorizuar për inspektimin dhe lëshimin e certifikatës ADR automjetit të lejuar paraprakisht për transportin e materieve të rrezikshme, kur i është hequr autorizimi për punë ose kur i është shqiptuar masa ndalim për kryerjen e punëve, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(9) Gjobë në shumë prej 3.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje shërbimit teknik të autorizuar për inspektim dhe lëshimin e certifikatës ADR automjetit të lejuar paraprakisht për transportin e materieve të rrezikshme, nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (2) (3), (4) dhe (7) të këtij neni.

(10) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë” do t'i shqiptohet personit përgjegjës te shërbimi teknik të autorizuar për inspektim dhe lëshim të certifikatës ADR automjetit të lejuar paraprakisht për transportin e materieve të rrezikshme, nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve (8) dhe (9) të këtij neni”.

(11) Gjobë në shumë prej 250 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punonjësit profesionist në shërbim teknik të autorizuar për inspektim dhe lëshim të certifikatës ADR automjetit të lejuar paraprakisht për transportin e materieve të rrezikshme për kundërvajtje të kryer nga paragrafët (4) dhe (7) të këtij neni.”.

Neni 58

Ne nenin 87 në paragrafin (1) pas numrit "22" shtohet numri "54-a,".

Në paragrafin (8) fjalët: "paragrafi (6)" zëvendësohet me fjalët: "paragrafi (7)".

Neni 59

Në nenin 88 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Për kundërvajtje të përcaktuara në nenet 17, 26, 33, 35, 36, 37, 38, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 49, 51, 53, 54, 56-a, 62-a, 65, 65-a, 66-v, 66-g, 66-ll, 81-a, 81-b, 82 dhe 85 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje mban edhe sanksione për kundërvajtje shqipton Ministria e Punëve të Brendshme.“.

Neni 60

Në nenin 90 në paragrafin (1) fjalët: "neni 41" zëvendësohet me fjalët: "nenet 33-a dhe 41".

Neni 61

Në nenin 92 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 26, 31-a, 33, 35, 36, 37, 38, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 49, 51, 54, 65, 65-a, 81-a, 81-b, 82 dhe 85 të këtij ligji, nëpunësi policor në uniformë është i detyruar kryerësit të kundërvajtjes, personit fizik, t'i përgatisë procesverbal për kundërvajtje të kryer në komunikacion, përkatësisht procesverbal për kontroll të rregullt automjetit teknik në rrugë publike, në pajtim me nenin 82 të këtij ligji dhe t'i japë urdhërpagesë për kundërvajtje, si dhe t'i propozojë procedurë për barazim para se të parashtrijë kërkesë për procedurë për kundërvajtje.“.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Për kundërvajtjet nga nenet 17, 33, 37, 40, 41, 56-a dhe 62-a të këtij ligji, të përcaktuara në procedurë administrative, personi i autorizuar zyrtar është i obliguar të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje.".

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 26, 37, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 47, 49, 51, 53, 54, 56-a, 62-a, 65, 65-a, 66-v, 66-g, 66-ll, 81-a, 81-b dhe 85 të këtij ligji, kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet personi juridik dhe personi përgjegjës te personi juridik, nëpunësi në uniformë policor, i përgatit procesverbal për kundërvajtje të kryer në komunikacion dhe parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje te Komisioni nga neni 88 paragrafi (2) të këtij ligji.“.

Neni 62

Pas nenit 92-a shtohet nen i ri 92-b si vijon:

"Neni 92-b

Rregullat e ministrit të Punëve të Brendshme

Ministri i Punëve të Brendshme do të miratojë rregulla më të përafërta për formën dhe përmbajtjen e formularit të urdhërpagesës për kundërvajtje, procesverbalit për kundërvajtje të kryer në komunikacion dhe procesverbalit për kontroll të rregullsisë teknike të automjetit në rrugë publike.“.

Neni 63

Dokumente për automjet të lejuar

(1) Dokumentet "Vërtetim për përshtatje të një automjetit të tipit të lejuar", "Vërtetimi për përshtatje për automjet të tipit të lejuar", "Pajtim për regjistrim" dhe "Vërtetim për përshtatje të automjetit të modifikuar", të cilat kanë të bëjnë me automjete speciale për transport të materieve të rrezikshme, e zëvendësojnë dokumentin "Certifikatë e automjetit të testuar" në pajtim me nenin 63 të Ligjit për transport të materieve të rrezikshme në komunikacionin rrugor dhe hekurudhor.

(2) Certifikata e automjetit të testuar të dhënë në pajtim me nenin 63 të Ligjit për transport të materieve të rrezikshme në komunikacion rrugor dhe hekurudhor, vazhdojnë të vlejnjë.

Neni 64

(1) Personat fizikë dhe juridikë, të cilët në mënyrë të ndërgjegjshme drejtojnë automjetet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe që nuk e kanë vazhduar vlefshmërinë e lejes së qarkullimit për më shumë se dy vjet nga dita e skadimit të vlefshmërisë së tyre, janë të obliguar që nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji ta çregjistrojnë automjetin e tyre në Ministrinë e Punëve të Brendshme – rajonin e regjistrimit ku automjeti është mbajtur në evidencë përfundimisht me 31 dhjetor 2019 .

(2) Me kërkesën për çregjistrim të automjetit, pronari i automjetit e bashkëngjit lejen e qarkullimit dhe/ose dëshmi tjetër me të cilën dëshmohet pronësia e automjetit dhe targat e regjistrimit.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni kur pronari i automjetit nuk e posedon lejen në komunikacion për automjetin dhe/ose nuk posedon një ose dy targa të regjistrimit të dhëna për automjetet, i njëjti me deklaratë me shkrim të dhënë para Ministrisë së Punëve të Brendshme - rajonin e regjistrimit ku automjeti mbahet në evidencë, e deklaron arsyen për humbjen e lejes së qarkullimit dhe ose targave të regjistrimit.

(4) Ministria e Punëve të Brendshme - rajoni i regjistrimit ku mbahet automjeti në evidencë në bazë të dëshmive nga paragrafi (2) dhe/ose paragrafi (3) të këtij neni çregjistrimin e evidenton në lejen e qarkullimit për automjetin ose në vërtetimin që e jep për automjetin, ndërsa e mban sipas detyrës zyrtare, e shënon datën e çregjistrimit të bërë dhe nënshkrimin e personit zyrtar i cili e ka kryer çregjistrimin e automjetit.

(5) Çregjistrimi i automjetit evidentohet në lejen e qarkullimit ose në vërtetimin e dhënë për automjetin për të cilin Ministria e Punëve të Brendshme – rajoni i regjistrimit ku mbahet evidenca e automjetit, ku automjeti është çregjistruar e mban sipas detyrës zyrtare, ndërsa evidentohet edhe në regjistrin për automjete.

(6) Pas kalimit të afatit nga paragrafi (1) të këtij neni Ministria e Punëve të Brendshme automjetin do ta shlyejë nga evidenca e automjetit dhe do të ndërmarrë masa për marrjen e targave të regjistrimit në shpenzim të pronarit të automjetit në pajtim me nenin 40 të Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 140/2008, 53/11, 123/12, 70/13, 164/13, 138/14, 154/15, 192/15 dhe 39/16).

Neni 65

Shërbimet e autorizuara teknike janë të detyruar ta harmonizojnë punën e vet në pajtim me dispozitat e këtij ligji në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 66

Personat juridikë të cilët kryejnë transport auto taksi janë të detyruar ta harmonizojnë punën e vet në pajtim e dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e përcaktuara me këtë ligj, ndërsa në afat prej 90 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të rregullës së paraparë në nenin 9 të këtij ligji e që ka të bëjë me nenin 27 paragrafin (1) alinetë 1 dhe 5 të Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 140/2008, 53/11, 123/12, 70/13, 164/13, 138/14, 154/15, 192/15 dhe 39/16).

Neni 67

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 68

(1) Kategorizimi ekologjik i automjeteve nga neni 5-b i përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji do të fillojë të zbatohet pas kalimit të afatit prej 12 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të rregullës së përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji, e që ka të bëjë me nenin 11 paragrafi (1) alineja 20 të Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 140/2008, 53/11, 123/12, 70/13, 164/13, 138/14, 154/15, 192/15 dhe 39/16).

(2) Automjetet e kategorisë së dytë ekologjike me emision të gazrave të nxjerra EURO 4 në periudhë prej tre vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji do të shënohen me etiketë ekologjike të kategorisë së parë ekologjike.

Neni 69

Personat juridikë të cilët kryejnë punë të kontrollit teknik të automjetit dhe personat juridikë të cilët bëjnë punë të shërbimeve teknike për inspektim dhe dhënie të ADR certifikatës për automjet të lejuar për transport të materieve të rrezikshme, e të cilët janë të autorizuara nga Ministria e Punëve të Brendshme janë të detyruar ta harmonizojnë punën e vet në pajtim me dispozitat e këtij ligji në periudhë prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 70

Procedurat për autorizim për kryerjen e punëve të shërbimeve teknike, për autorizim të personave juridikë për kryerjen e kontrollit teknik të automjeteve, për autorizim të personave juridikë të cilët bëjnë kontroll teknik të automjeteve për kryerjen e identifikimit dhe identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes teknike të automjeteve, si dhe punëve të personave juridikë të cilët

bëjnë përsosjen e pajisjeve për motor dhe gaz të lëngët të naftës dhe/ose motor të gazit tokësor të komprimuar, do të mbarojnë në pajtim me Ligjin për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 140/2008, 53/11, 123/12, 70/13, 164/13, 138/14, 154/15, 192/15 dhe 39/16).

Neni 71

Në tërë tekstin e Ligjit fjalët: "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë së Veriut".

Neni 72

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".